

1 E enjte, 24 mars 2022

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes  
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 14.32

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përshëndetje, të gjithëve  
8 dhe mirë se keni ardhur të gjithë brenda dhe jashtë sallës.

9 Znj. Sekretare, ju lutem thërrisni çështjen.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar  
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
12 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, z. Selimi  
13 dhe Jakup Krasniqit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.  
15 Sekretare.

16 Tani do t'ju kërkoja palëve që të prezantohen, duke  
17 filluar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

18 Znj. Prokurore, fjala për ju.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëdita, të gjithëve. Dhe  
20 mirëdita, të gjithëve ju që na ndiqni. Nga Zyra e Prokurorit  
21 të Specializuar kemi Alan Tieger, Prokuror i Lartë; unë, Clare  
22 Lawson, Prokurore e Lartë; dhe Halling, Prokuror po ashtu.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Tani do t'ia jap fjalën Mbrojtjes, duke filluar me z.  
25 Kehoe.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Përshëndetje. Unë jam z. Gregory  
2 Kehoe, Luca Misetic, Dastid Pallaska, Sophie Menegon, Bonnie  
3 Johnston dhe Janathan Greenblatt i cili po na ndjek nga video,  
4 të gjithë jemi Mbrojtja për z. Thaçi.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përshëndetje. Mbrojtja për  
6 z. Veseli.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]  
8 Përshëndetje. Ne, skuadra jonë përbëhet nga Haradin Kuçaj,  
9 Tess Huhes, Ben Emmerson dhe pjesa tjetër e ekipit për z.  
10 Veseli.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

12 Z. Young, ju lutem.

13 Z. YOUNG: [Përkthim] David Young përfaqësues i z. Rexhep  
14 Selimi. Ndihmohem nga Geoffrey Roberts, doktoreshë Rudina  
15 Jasini, Natalia Ryzhenko dhe Riva Gecaj. Faleminderit shumë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

17 Tani më lejoni t'i jap fjalën znj. Alagendra.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]  
19 Përshëndetje. Unë ju ndjek nga larg jam znj. Alagendra. Dhe  
20 kemi të pranishëm në sallë z. Ellis, z. Victor Baiesu dhe  
21 Mentor Beqiri. Kemi dhe Fauziah Mohd-Taib që ndjek nga larg.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Për procesverbal, dua t'ju them z. Thaçi, z. Veseli. z.  
24 Selimi dhe z. Krasniqi e ndjekin këtë seancë përmes  
25 videokonferencës.

1 Avokati i Viktimave mendoj që nuk po ndjek aktualisht.

2 Më lejoni që të pyes Sekretaren.

3 Ju lutem, znj. Sekretare, a mund të konfirmoni që ai po e  
4 ndjek ose jo seancën dhe ju lutem shihni në qoftë se ka ndonjë  
5 problem teknik.

6 [Trupi Gjykses dhe Administratorja këshillohen]

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sekretarja më thotë që ka  
8 pasur ca probleme për lidhjen me z. Laws dhe lidhja po  
9 mundohet që të realizohet. E shoh që z. Laws është në ekran  
10 ndërsa po flas tani.

11 [Trupi Gjykses dhe Administratorja këshillohen]

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më thanë që z. Laws po  
13 mundohet që të lidhet. Nuk është lidhur siç duhet ende, por më  
14 thonë që mund të na dëgjojë përmes telefonit.

15 Kështu që do t'i kërkoja Sekretares që të na informonte  
16 në momentin kur të ketë më tepër informacion lidhur me këtë  
17 çështje.

18 Tani z. Nilsson, fjala për ju, për Zyrën Administrative.

19 Z. NILSSON: [Përkthim] Përshëndetje, i nderuar Gjykatës.  
20 Zonja dhe zotërinj, unë jam Jonas Nilsson nga Zyra  
21 Administrative.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe për procesverbal, unë  
23 jam Nicolas Guillou, që jam Gjykatës i Procedurës Paraprake.

24 Unë u kam kërkuar palëve që të bëjmë parashtrimet e  
25 duhura.

1 Ndërkohë që më datën, 22 mars 2020 [sipas përkthimit]  
2 ZPS-ja dhe dy ekipe të Mbrojtjes ofruan konstatimet e tyre me  
3 shkrim në përputhje me urdhrin për konferencën për ecurinë e  
4 njëmbëdhjetë të çështjes.

5 Qëllimi kryesor i seancës për ditën e sotme është që të  
6 shikojmë ecurinë e çështjes dhe të diskutojmë për çështje që  
7 janë pjesë e agjendës. Do të diskutojmë për sa i takon  
8 çështjeve që kanë të bëjnë me: nxjerrjen, përkthimet, hetimet  
9 e ZPS-së, hetimet e Mbrojtjes, propozimet për mbarëvajtjen e  
10 çështjes.

11 Dua t'i ftoj palët që të na përditësojnë lidhur me  
12 secilën prej këtyre pikave.

13 Tani le të diskutojmë për pikën e parë e cila është e  
14 përmendur në vendimin e kësaj konferencë për ecurinë e  
15 çështjes. Dhe do të doja t'u kërkoja të gjitha palëve që të  
16 shprehen lidhur me pikën e parë që janë nxjerrja e  
17 dokumenteve.

18 Së pari, do t'ju pyes lidhur me materialet të cilat kanë  
19 rrjedhë nga procedurat e tjera; së dyti, materialet e  
20 përmendura nga ZPS-ja; së treti, materiali sipas rregullit 103  
21 që janë materiale shfajësuese; dhe, së fundi, rregullat sipas  
22 rregullit 107 që është material i mbrojtur për të cilët  
23 kërkohet pëlqimi i ofruesit.

24 Le të fillojmë me pikën e parë, pra, nxjerrja e  
25 materialeve provuese të cilat rrjedhin nga proceset e tjera.

1 Në parashtrimet me shkrim, ZPS-ja ka thënë që ka  
2 materiale të tjera me interes që rrjedhin nga procese të tjera  
3 të cilat po përgatiten për nxjerrje dhe/ose për njoftim në  
4 këtë çështje. ZPS-ja ka specifikuar që pjesa dërrmuese e  
5 këtyre materialeve kërkojnë redaktime të shumta dhe masa të  
6 lidhura mbrojtëse në mënyrë që ato t'i vihen në dispozicion  
7 çështjes dhe në mënyrë që të mund të parashtrojnë masat  
8 mbrojtëse.

9 Duam që ZPS-ja të japë afatet kohore për kërkesat për  
10 masa mbrojtëse dhe për të konfirmuar që nuk ka mbetur më  
11 material nën rregullin 102(1) që duhet t'i nxirret Mbrojtjes.

12 Përpara sesa t'ju jap fjalën, znj. Prokurore, më lejoni  
13 që të flas pak me Sekretaren sa i takon z. Laws.

14 Shoh që z. Laws është lidhur me ne.

15 Z. Laws, na shikoni?

16 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po ju shoh.  
17 Mirëdita të gjithëve. Ju kërkoj ndjesë që ju bëra të prisnit.  
18 Kam pasur disa probleme sa i takon lidhjes, ndërkohë që  
19 aktualisht çdo gjë funksionon siç duhet.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Laws.

21 Tani më lejoni t'i jap fjalën ZPS-së sa i takon pikës së  
22 parë në agjendë.

23 Znj. Prokurore, fjala për ju.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

25 Ne nuk kemi asgjë për të shtuar plus asaj që kemi parashtruar

1 në parashtrimet tona të protokolluara. Sa i takon dokumenteve,  
2 ne parashikojmë që ato të jenë të gatshme në gjysmën e parë të  
3 prillit.

4 Sa i takon rregullit nën materialin 102(b), duam të  
5 informojmë Gjykatën që dokumentet të cilat janë kërkuar dhe  
6 për të cilën është kërkuar nxjerrja, ato do të përpilohen si  
7 pjesë e paketës 201. Pra, do të bëhen disa rregullime, do të  
8 shikohen, do të vëzhgohen në përputhje me urdhrin që keni  
9 nxjerrë ju, i nderuar Gjykatës. Ndërkohë që tani mund të them  
10 që kemi identifikuar një regjistrim, incizim audio që ka një  
11 cilësi shumë të keqe dhe që lidhet me një materialeve që janë  
12 nxjerrë. Kemi gjithashtu identifikuar edhe një shënim me  
13 shkrim dore me një dëshmitar që ofron hollësi të tjera lidhur  
14 me informacionin që i gjithë, siç thashë, domethënë, është  
15 nxjerrë.

16 Kështu që parashikojmë që të kemi disa dokumente, por  
17 këto janë dy dokumente të cilat mund të identifikoj për  
18 Gjykatën deri tani. Kur të vijë koha do të bëjmë kërkesën e  
19 nevojshme dhe do t'i analizojmë ato.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Kehoe, fjala për ju.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Si  
23 me të gjitha çështjet e tjera, elementi kohë është shumë i  
24 rëndësishëm. Ne duam që të ecim përpara dhe kjo është në  
25 interesin e të akuzuarve.

1 Në mënyrën sesi e kam kuptuar unë afatin kohor lidhur me  
2 nxjerrjen e dokumenteve, urdhri i lëshuar nga Gjykata ishte më  
3 datë 31 mars. Nëse nuk gabohem 31 marsi është javën që vjen.  
4 Kështu që do të doja që t'i kërkoja Gjykatës që të konstatonte  
5 që ZPS-ja do të realizonte afatin e përcaktuar më datë 31  
6 mars. Për çdo informacion tjetër, i cili rrjedh nga proceset e  
7 tjera, pra, duhet që të kemi një kohë më specifike. Sepse  
8 Prokuroria tha nga gjysma e parë e prillit. Por duam të dimë  
9 pak më tepër me saktësi, se kur do të jetë kjo kohë?

10 Pra, është e rëndësishme për neve që të dimë më shumë për  
11 afatet kohore në mënyrë që të dimë sesi të procedojmë më tej.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

13 Z. Emerson.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Znj.

15 O'Reilly do të trajtojë çështjet e nxjerrjes, megjithatë, më  
16 lejoni të them diçka. Z. Veseli duhet të largohet nga  
17 konferenca për ecurinë e çështjes sepse ka një telefonatë të  
18 organizuar paraprakisht me fëmijët e tij.

19 Domethënë, thjesht doja t'jua thoja paraprakisht që në  
20 mes të konferencës, pra, klientit tim do t'i duhet të  
21 largohet.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emerson.

23 Nuk ka asnjë lloj problemi prej nesh, prej meje. Dhe është  
24 bërë koordinimi me Njësinë e Administrimit Gjyqësor sepse  
25 duhet që të nënshkruhet një dokument i caktuar për pjesën e

1 dytë kur z. Veseli nuk do të jetë këtu, sepse duhet, pra, që  
2 të bëhen procedurat përkatëse nga Njësia e Administrimit  
3 Gjyqësor për gjysmë ore në vijim. Por nuk është asnjë lloj  
4 problemi.

5 Dhe faleminderit që na e thatë në këtë pikë këtë.

6 Znj. O'Reilly, për nxjerrjen e dokumenteve.

7 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Kërkesa e vetme që kam unë  
8 është që të përcaktohet një afat kohor specifik, pra, ZPS-ja  
9 tha që mbase mund të kenë mundësi që t'i nxjerrin këto  
10 dokumente nga mesi i prillit. Kështu që do të donim që të  
11 dinim më tepër hollësi lidhur me ditën konkrete.

12 Sa i takon elementeve të tjerë, dokumenteve të tjerë,  
13 Prokuroria na përmendi vetëm dy dokumente, thjesht do të doja  
14 të dija në qoftë se bëhet fjalë vetëm për këto dy dokumente  
15 apo bëhet fjalë edhe për dokumente të tjera të cilat do të  
16 nxirren deri nga mesi i prillit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 z. Young.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] Pra, jam plotësisht dakord për atë  
20 çfarë u tha nga ekipi i z. Veseli, pra, duhet që të kemi një  
21 afat specifik, një ditë specifike sa i takon dorëzimit. Sepse,  
22 siç e dimë, që kemi të paktën 12 dëshmitarë në procese të  
23 tjera të cilët janë dëshmitarë gjithashtu edhe në këtë  
24 çështje. Kështu që është shumë mirë që ne të dimë specifikisht  
25 se kur do të nxirren dokumentet.



1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra ose z.

2 Misetic.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Z. Misetic, ju kërkoj ndjesë se do  
4 të jem unë personi që do flas kryesisht në këtë çështje sot.

5 Megjithatë, më lejoni të them, që kemi 12 dëshmitarë të  
6 cilët janë të përfshirë në procese të tjera dhe të cilët  
7 përfshihen dhe në çështjen në fjalë. Kështu që nuk shohim  
8 ndonjë arsye për shtyrjen më të afatit kohor për nxjerrjen e  
9 informacionit lidhur me të.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Sekretare [sipas  
11 përkthimit], a doni t'i përgjigjeni komenteve dhe ju lutem, a  
12 mund të konfirmoni në qoftë se kërkesa do të depozitohet në  
13 javën e parë të prillit për masa mbrojtëse në qoftë se do bëni  
14 një aplikim të tillë? Dhe ju lutem, a mund të jepni më shumë  
15 informacion me më tepër hollësi lidhur me afatin për nxjerrjen  
16 e dokumenteve.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
18 Sa i takon pyetjeve të cilat u ngritën nga Mbrojtja, mendoj që  
19 i shtrova ato në parashtrimet fillestare. Dokumentet për të  
20 cilat shtyrja është dhënë janë nxjerrë në përputhje me paketën  
21 201.

22 Ndërkohë që sa i takon kohës kur duhet të nxirren këto  
23 dokumente, konfirmoj sërish atë çfarë thashë më përpara, që do  
24 të nxirren në gjysmën e parë të prillit.

25 Sa i takon dokumenteve të tjera, po, ndërkohë ne po

1 përpilohet një kërkesë lidhur me to.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Le të kalojmë  
3 tek dokumentet të cilat kanë të bëjnë me rregullin 102(3). I  
4 kujtoj palëve se në konferencën për ecurinë e çështjes të  
5 organizuar më 29 tetor 2021, unë pezullova afatin e mbetur të  
6 Mbrojtjes për materialin nën rregullin 102(3). Që prej  
7 konferencës së fundit për ecurinë e çështjes, ZPS-ja ka thënë  
8 që ka nxjerrë një paketë të mëtejshme, paketë të shtatë të  
9 materialeve nën rregullin 102(3) që përfshin 5298 dokumente  
10 dhe numri, në fakt, është më i madh sesa numri i dokumenteve  
11 të paketave të mëparshme.

12 ZPS-ja ka thënë që do t'i japë Mbrojtjes një dokument në  
13 *spreadsheet* në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga rregulli  
14 102(3), përfshirë këtu dhe numrat e dokumenteve. Megjithatë,  
15 sipas ZPS-së, numri i dokumenteve sipas rregullit 102(3) të  
16 nxjerra gjatë javëve të fundit ka qenë më i ulët sesa  
17 parashikimi. Në fakt, sipas Mbrojtjes vetëm një pakicë e  
18 dokumenteve të kërkuara janë nxjerrë deri tani, gjë e cila  
19 pengon hetimet e Mbrojtjes.

20 Mbrojtja tregon, thotë po ashtu që nuk është në pozitë që  
21 të përcaktojë sesa dokumente sipas njoftimit të rregullit  
22 102(3) janë nxjerrë në përgjithësi sepse ZPS-ja kohët e fundit  
23 ka nxjerrë disa dokumente nën rregullin 103 të cilat u  
24 kërkojnë sipas rregullit 102(3), por nuk ka bërë lidhjen e  
25 këtyre dokumenteve me njoftimin që kërkohej sipas rregullit

1 102(3).

2 Mbrojtja i kërkon ZPS-së që të bëjë një vlerësim realist  
3 të kohës që do t'i duhet ZPS-së që të përfundojë nxjerrjen e  
4 të gjithave kërkesave pezull sipas rregullit 102(3). Së fundi,  
5 ZPS-ja mendoi që rivendosja e afatit kohor për kërkesat dhe  
6 përgjigjet sipas rregulli 102(3) nuk shërben për ta avancuar  
7 procesin në këtë kohë.

8 Megjithatë, Mbrojtja parashtron se afate më strikte për  
9 nxjerrjen sipas rregulli 102(3) duhet t'i vendosen ZPS-së në  
10 mënyrë që ajo të mos pengojë më tej përgatitjen e Mbrojtjes  
11 për gjyqin.

12 Në fund, Mbrojtja nuk e mbështet rivendosjen e afatit  
13 kohor për kërkesa që kanë të bëjnë me rregulli 102(3).

14 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën lidhur me këtë pikë.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
16 Gjykatës.

17 Siç e keni vënë re, numrat kanë ndryshuar krahasimisht me  
18 parashtrimet e mëparshme. Që prej konferencës së mëparshme për  
19 ecurinë e çështjes, ne kemi nxjerrë 19 paketa në bazë të  
20 materialit sipas rregullit 102(3), është paketa e cila  
21 përfshin 8284 dokumente

22 Përveç kësaj, kemi parashtruar dhe kërkesa për masa  
23 mbrojtëse që lidhen me kërkesën sipas rregulli 102(3) të  
24 Mbrojtjes së Krasniqit dhe të Mbrojtjes së Veselit. Dhe  
25 gjithashtu jemi përfshirë në diskutime me këto ekipe lidhur me

1 këtë natyrë të dokumenteve. Dhe i falënderojmë ato për  
2 bashkëpunimin.

3 Sa i takon kërkesave për të cilat ne jemi angazhuar nga  
4 konferenca e mëparshme për ecurinë e çështjes, unë konfirmoj  
5 kërkesën e z. Veseli që nga data 7 tetor dhe kërkesën e  
6 Veselit që nga data 16 tetor dhe që këto kërkesa janë trajtuar  
7 plotësisht. Kanë mbetur vetëm disa dokumente, pak dokumente,  
8 të cilat kanë të bëjnë me aspektin material.

9 Lidhur me kërkesat sipas rregullit 102(3), që janë 25  
10 kërkesa, 12 prej tyre janë përfunduar, ndërkohë që shumë të  
11 tjera janë thuajse 75 për qind të përmbushura, domethënë  
12 gjysma tjetër thuajse janë trajtuar në masën prej 75 për qind.  
13 Edhe ne planifikojmë që gjatë tre javëve të ardhshme të kemi  
14 mundësinë që të nxjerrim të gjithë dokumentet e tjera.

15 Për kërkesa të cilat janë përfunduar, neve do t'ju japim  
16 ekipeve të Mbrojtjes *spreadsheet*-e të cilat janë të  
17 konsoliduara lidhur me kërkesat e tyre. Dhe sa i takon  
18 kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për të gjurmuar kur dokumente  
19 të caktuara janë nxjerrë, në veçanti në bazë të një rregulli  
20 tjetër, ne do ta përfshijmë këtë informacion në *spreadsheet*-et  
21 që do t'i japim ekipeve të Mbrojtjes.

22 Përveç progresit që ne kemi arritur deri tani, ne  
23 vazhdojmë që të njoftojmë Mbrojtjen për kërkesat mbi rregullin  
24 102(3). Besoj që kemi marrë 11 kërkesa të tjera që prej  
25 konferencës së fundit për ecurinë e çështjes. Kishte një

1 kërkesë shtesë të bërë më datë 18 mars edhe kemi marrë  
2 gjithashtu një kërkesë plus nga Mbrojtja e z. Thaçi orën e  
3 fundit.

4 Pavarësisht progresit real të bërë për parashtrimet e  
5 kërkesave për masat mbrojtëse, ne kemi shkruar edhe, në  
6 parashtrimet me shkrim, sipas nxjerrjeve të rregullit 102(3)  
7 dhe këto dokumente kanë qenë më shumë se ç'kishim planifikuar  
8 se të ishin. Ne jemi munduar që t'i trajtojmë kërkesat në  
9 momentin që ato na kanë ardhur.

10 Ekipi i nxjerrjes është prekur për shkak të sëmundjes së  
11 tyre ose të familjarëve të tyre dhe kemi pasur mungesa në  
12 staf. Kështu që si rezultat i këtyre rrethanave të pafata, si  
13 rezultat i COVID-19, ne kemi pasur kufizimet tona megjithatë  
14 po mundohemi që të trajnojmë ekipe të tjera të Mbrojtjes në  
15 mënyrë të tillë që të mund të bëjmë nxjerrjen dhe nxjerrjet e  
16 dokumenteve të cilat ne kemi bërë të hënën dhe të martën këtë  
17 javë janë shenjë e masave të tjera shtesë që ne kemi marrë  
18 duke trajnuar dhe persona të tjerë për t'ju shtuar ekipit.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

20 Prokurore.

21 z. Kehoe.

22 Z. KEHOE:[Përkthim] Sigurisht që ne kemi disa kërkesa  
23 sipas materialit 102(3). Ne kemi kërkuar që prej konferencës  
24 së mëparshme për ecurinë e çështjes 1000 dokumente. Dhe sot që  
25 flasim asnjë prej këtyre kërkesave nuk është përmbushur. Edhe

1 kolegët kanë shkruar të njëjtën gjë që po kërkohet, po ju  
2 duhet një periudhë e gjatë kohe ZPS-së në mënyrë që t'i  
3 përgjigjen kërkesave tona.

4 Ne nuk kemi pikë dyshimi, që ndërkohë që do të bëjmë  
5 përparim me hetimet, ne do të bëjmë më shumë kërkesa për  
6 dokumentet sepse kjo është thjesht mënyra logjike sesi do të  
7 procedojnë gjërat. Por fakti që ne duam që të vazhdojmë me  
8 këtë çështje më përpara, e vërteta është që ne jemi shumë të  
9 shqetësuar me vonesën në dhënien e këtij informacioni. Nuk e  
10 di në qoftë se informacioni do të na mjaftojë edhe kur ta  
11 marrim apo do të na çojë në një tjetër drejtim.

12 Kërkesat tona ne nuk është se i bëjmë pa i menduar thellë  
13 lidhur me faktin që çfarë na duhet. Ne nuk është se thjeshtë  
14 po kërkojmë çfarëdo lloj dokumenti. Po kërkojmë dokumente të  
15 cilat janë me interes për neve.

16 Por do të doja t'ju thosha që jemi vërtetë shumë të  
17 shqetësuar për këtë gjë. Dhe do të donim të shihnim dhe nuk  
18 dimë në qoftë se Gjykata mund të përcaktojë disa udhëzime për  
19 ZPS-në lidhur me përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin  
20 nga rregulla 102(3).

21 Lidhur me detyrimet tona për 102(3) dhe afatet kohore,  
22 është e pamundur për ne të themi gjë dhe kjo duhet të mbetet e  
23 hapur në këtë pikë. Kemi shumë dëshmitarë, pra, janë gati 100  
24 dëshmitarë, të cilët ne nuk e dimë as se kush janë. Janë emra  
25 të cilat janë redaktuar, vende të cilat janë redaktuar. Edhe,

1 i nderuar Gjykatës, ju keni parë edhe Aktakuzën e keni parë  
2 edhe atë sesi është redaktuar. Pra, ne kur të marrim këtë  
3 informacion do të kërkojmë më tepër informacion domethënë  
4 sipas rregullit 102(3)?

5 E kuptoj që ka ca vështirësi me të cilat është hasur ZPS-  
6 ja, megjithatë kemi dhe ne vështirësitë njësoj nga Mbrojtja po  
7 pavarësisht kësaj ne duam që ta çojmë përpara çështjen sepse  
8 arsyeja jonë e vetme është që duam ta çojmë përpara çështjen  
9 pasi të akuzuarit vazhdojnë që të jenë të burgosur.

10 Kështu që nuk e di se në qoftë se i nderuar Gjykatës mund  
11 të jepni udhëzime strikte për t'u siguruar që kjo çështje bën  
12 progres përpara dhe sigurohemi që dokumente sipas 102(3)  
13 nxirren në kohën e duhur.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

15 Znj. O'Reilly, ju lutem.

16 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
17 Gjykatës.

18 Do të kaloj statistikat shumë shpejt siç u kërkua prej  
19 nesh.

20 Ne kemi kërkuar 1019 dokumente që prej konferencës së  
21 fundit, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 20.506.

22 Domethënë, siç mund ta shikoni ne nuk është se po kërkojmë të  
23 marrim të gjithë dokumentet, thjesht po e fokusojmë ose, le të  
24 themi, po e ngushtojmë fushën e dokumenteve të cilat neve po  
25 kërkojmë nga ZPS-ja, në përputhje me akuzat e ngritura në

1 Aktakuzë.

2 Ndërkohë që ZPS-ja ka nxjerrë 1695 dokumente. Ndërkohë që  
3 në përgjithësi, në total pra, kemi 10.123 dokumente domethënë  
4 ndërkohë që është bërë ca progres na është nxjerrë deri tani  
5 vetëm 50 për qind e dokumenteve që kemi kërkuar.

6 Çfarë do të thotë që duhet që Prokuroria të jetë dy deri  
7 tre herë më e shpejtë se çka qenë deri tani për të përmbushur  
8 kërkesat tona.

9 Lidhur me nevojat sipas rregullit 102(3) dhe 103, pra,  
10 ZPS-ja na tha që do të rregulloj; referimin e këtyre  
11 dokumenteve. Por problem për neve është që shtojca shpesh herë  
12 na vijnë shumë më vonë sesa dokumentet dhe për neve kjo na  
13 ngatërron, domethënë, në qoftë se e marrim si copëza  
14 informacionin, domethënë, është e vështirë për neve që të  
15 bëjmë lidhjen e duhur. Kjo nuk funksionon siç duhet dhe  
16 singerisht ju them, nuk e kuptoj se pse nuk mund të marrim  
17 numrin e dokumenteve së bashku ose paralelisht me nxjerrjen e  
18 tyre. Dhe ndoshta kjo është diçka që duhet ta trajtojë ZPS-ja,  
19 domethënë, sepse nuk e bën nxjerrjen e dokumenteve në të  
20 njëjtën kohë me numrin e tyre.

21 Z. Strong do ta trajtojë këtë gjë më shumë, por mendoj që  
22 është me shumë rëndësi që të sigurojmë mbarëvajtjen e  
23 çështjes. Dhe mendojmë që sa më shumë të marrim informacion aq  
24 më shumë do të kemi mundësi që të nxjerrim dokumente dhe  
25 pastaj ta çojmë drejt gjykimit këtë çështje.



1           Sa i takon çështjes së përkthimit, pozicioni ynë është se  
2 për aq kohë sa vendimi kuadër thotë që dokumentet duhet që të  
3 ofrohen në gjuhët zyrtare të kësaj Gjykate. Ndërkohë që  
4 pozicioni duket sikur nuk ndahet edhe nga anët e tjera.  
5 Domethënë, ZPS-ja nuk thotë që duhet që dokumentet të jepen në  
6 të gjitha gjuhët. Duhet të sqarohet kjo gjë dhe ky sqarim do  
7 të duhet të jepet me shkrim.

8           Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

9           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10          Z. Young, fjala për juve.

11          Z. YOUNG: [Përkthim] E vlerësojmë pranimin e  
12 mospërbushjes së parashikimit nga Prokuroria dhe e kuptojmë  
13 gjithashtu edhe pjesën e arsyetimit për stafin e sëmure dhe  
14 mungesat e stafit që prej datës së fundit të konferencës për  
15 ecurinë e çështjes. Megjithatë, i nderuar Gjykatës, ajo çfarë  
16 është më shqetësuese është që kërkesa e Mbrojtjes së Selimit  
17 për 39.839 dokument është bërë më datë 1 nëntor vitin që  
18 shkoi. Ndërkohë që kërkesa e dytë është bërë më datë 7 dhjetor  
19 2021, për 12.957 dokumente. Dhe, ajo çka dua të them, që pjesa  
20 dërrmuese e materialeve që ne kemi kërkuar, janë kërkuar që  
21 para pesë muajve.

22          Kështu që ne mendojmë që problemi real është një problem  
23 tjetër, është më i madh, domethënë mosfunksionimi i sistemit  
24 sepse nuk është përpunuar sasia e duhur e informacionit. Unë  
25 nuk jam shumë i informuar sa i takon materialitetit të

1 dokumentacionit që na nevojitet dhe ideja është që ky  
2 informacion duhet që të na vihet tani në dispozicion.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Mbase unë nuk ia arrita që ta bind  
4 Prokurorinë për kërkesën që bëra para gjashtë javësh. Sepse ne  
5 duam të dimë ekzaktësisht se kur do të jetë Prokuroria në  
6 gjendje të përpunojë kërkesën e saj. Nuk është -- e kam si  
7 kritikë por fakti është që ne duam të gjithë dhe ju,  
8 sigurisht, që doni ta çoni përpara këtë çështje edhe ne ashtu  
9 duam.

10 Ne kemi ecur nëpërmjet bërjes së kërkesave tona sipas  
11 njoftimit në bazë të rregullit 102(3). Dhe ne do të bëjmë dhe  
12 një kërkesë tjetër përpara konferencës së ardhshme.

13 Por kjo një çështje që ka ngelur. Kemi shumë pika të  
14 cilat duhen sqaruar përpara verës lidhur me hetimin tonë si  
15 Mbrojtje. Por çështja është, a mundet Prokuroria t'i nxjerrë  
16 dokumentet e saj? A mund të na i japi ato dokumente të cilat  
17 janë me rëndësi themelore për përgatitjen tonë? Kur do të  
18 ndodhi kjo? Ne duhet që të kemi një ide të saktë. Prokuroria  
19 duhet të ketë një ide se kur do të mund të na japi ne, si  
20 Mbrojtje, këtë afat. Atëhere dhe ne, bazuar në këtë, mund të  
21 marrim vendimet tona për menaxhimin e çështjes.

22 Për mendimin tim, shumë nga pikat e agjendës ngelen të pa  
23 realizuar për çfarë flasim për dy muaj, për tre muaj apo për  
24 më shumë muaj përpara se të nxirren të gjithë dokumentet.

25 Dhe jua kërkoj dhe njëherë juve, jua thamë dhe përpara

1 konferencës dhe Prokuroria e di që ne do ta bëjmë këtë pyetje:  
2 kur do të bëhet kjo gjë? Cili është vlerësimi i Prokurorisë?

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

4 T'i kthehem dhe njëherë Prokurorisë.

5 Dua që t'i përgjigjeni parashtrimeve të Mbrojtjes,  
6 sidomos tre pikave, për të cilat dua të dëgjojë mendimin tuaj.  
7 E para, është e mundur që të nxirrni provën bashkë me secilën  
8 paketë - më falni - të nxirrni numrin e provave bashkë me çdo  
9 paketë për të lehtësuar analizën e provave.

10 Pika e dytë gjithashtu e ka ngritur znj. O'Reilly. Ka të  
11 bëjë me përkthimin e materialit dhe nëse jeni të gatshëm që të  
12 zgjidhni ndonjë çështje përmes parashtrimeve me shkrim.

13 Dhe pika e tretë, që do të ngrija, në vijim të atyre që u  
14 ngritën nga të gjithë ekipet e Mbrojtjeve, kur do të jeni në  
15 gjendje të jepni një afat më të saktë për kërkesat në pritje,  
16 lidhur ose përmes numrit të provave materiale për çdo javë apo  
17 një afat për kërkesat që priten të realizohen.

18 Znj. Prokurore, keni fjalën.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po e filloj nga kërkesa e  
20 Mbrojtjes së z. Veseli.

21 Siç thashë përpara, vëllimi i paketave që ne nxjerrim po  
22 rritet dhe ne po punojmë njëkohësisht në shumë paketa, gjë që  
23 na e vështirëson punën për të dhënë një kohë të saktë sepse  
24 duhet të bëjmë kontrollin e të gjitha referencave. Janë  
25 informacione të cilat duhet t'i përmbledhim, t'i bëjmë gati.

1 Pamë që Mbrojtja e Veselit propozoi dhe një zgjidhje teknike  
2 për të gjurmuar këtë punë. Ne po e shohim nëse është e mundur  
3 ta bëjmë.

4 Për sa i takon përfshirjes së numrit të faqeve, kjo është  
5 një çështje teknike me të cilën do të merremi vesh mbas kësaj  
6 konference.

7 Por, sigurisht sa më shumë punë që ne bëjmë për çdo  
8 paketë kjo do të ndikojë dhe për ritmin e nxjerrjes së  
9 paketave në përgjithësi.

10 Për sa i takon përkthimeve, nëse ka diçka që mund ta  
11 diskutojmë *inter partes*, pra, me palët, jemi të gatshëm ta  
12 bëjmë.

13 Për Mbrojtjen e z. Selimi, ata përmendën një kërkesë të  
14 bërë në nëntor që përfshinte 40.000 materiale. Që është  
15 pothuaj e gjithë lista dhe nuk është për t'u çuditur që ne s'e  
16 kemi përmbushur atë kërkesë. Por, megjithatë, po punojmë për  
17 të.

18 Ata më pas përcaktuan përparësitë e disa materialeve që  
19 donin dhe e vlerësojmë këtë gjë nga ana e tyre. Afërsisht  
20 përcaktuan 400 prova si përparësore që duhet të ishin pjesë e  
21 kërkesës së tyre të parë dhe ne po punojmë për këtë,  
22 konkretisht për ato dokumente që kanë përparësi, një pjesë e  
23 tyre janë nxjerrë ndërkohë dhe një numër i madh janë në fazë  
24 të avancuar të përpunimit nga ana jonë.

25 Lidhur me afatet vlerësimet që kërkohen prej nesh, siç

1 thashë, që nga konferenca e fundit kemi marrë dhe 11 kërkesa  
2 të tjera. Keni parë, për shembull, se kërkesa e marrë nga  
3 Mbrojtja e Krasniqit gjatë dy javëve të fundit është pothuaj  
4 dy herë më e madhe se kërkesat e tjera që kanë bërë më parë  
5 dhe janë parashikuar të bëhen kërkesa të tjera shtesë. Çdo  
6 kërkesë mund të jetë shumë e ndryshme sa i takon kohës që  
7 kërkohet për rishikimin lidhur me madhësinë, kohëzgjatjen e  
8 materialeve, natyrën e tyre dhe sigurisht edhe për ndonjë  
9 mbivendosje që mund të ketë midis kërkesave të mëparshme që  
10 janë bërë, gjë që do të na e lehtësonte punën për ta bërë më  
11 shpejt.

12 Me këto gjëra, nuk është e mundur që unë t'u jap një  
13 vlerësim të njëmend lidhur me datën, por mund t'ju jap një ide  
14 lidhur me ritmin e punës sonë. Edhe pse, mbase nuk është  
15 pasqyruar në paketat e nxjerrjes së dokumenteve, ne kemi  
16 ndjekur një ritëm të nxjerrjes mesatarisht 5000 dokumente në  
17 javë gjatë kësaj periudhe. Siç thashë përpara, herës tjetër,  
18 kjo nuk përkthehet patjetër në nxjerrje dokumentesh. Pikë së  
19 pari sepse shumica e tyre kërkojnë dhe një rishikim të dytë  
20 për qëllime redaktimi dhe, nga përvoja kemi parë, që është një  
21 kontroll cilësie shumë i rëndësishëm. Por, megjithatë, paketat  
22 duhet të kontrollohen nga pikëpamja e metadatave, që ka dalë,  
23 ka qenë një pengesë për ne gjatë javëve të fundit por po  
24 marrim masat ta korrigjojmë. Dhe shpresojmë që të kapim, pra,  
25 ritmin që kërkohet.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

2 Prokurore.

3 Tani të kalojmë te materialet e rregullit 103.

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, lidhur  
5 me numrat e provave apo dokumenteve, në fakt, nuk kemi marrë  
6 asnjë numër duke filluar që nga tetori, pra, që i bie gjashtë  
7 muaj. Dhe kjo do të na ndihmonte shumë. Dhe po e kuptoj që do  
8 të kërkonte kohë më shumë, por ne do të ishim shumë më të  
9 kënaqur të prisnim pak më shumë dhe t'i merrnim materialet me  
10 numra sesa po të mos marrim për gjashtë muaj asnjë numër.

11 Një gjë që harrova ta them përpara, lidhet me një çështje  
12 që e ngrita herën e kaluar, lidhur me materialet shtesë që po  
13 marrim -- që po merr dhe ka në kontroll ZPS-ja. Qëndrimi ynë  
14 është që edhe kjo duhet rishikuar, duhet t'i nxirren  
15 materialet Mbrojtjes. Pra, nuk di nëse ka ndonjë dispozitë  
16 ligjore që thotë ndryshe, nëse po, do të doja të sqarohesha.

17 Faleminderit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

19 O'Reilly.

20 Znj. Prokurore, doni t'i përgjigjeni pikës së fundit?

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po. Faleminderit.

22 Dokumentet që janë marrë janë sqaruar, janë miratuar deri  
23 në janar dhe jemi duke rishikuar si për qëllimet e njoftimit  
24 102(3) ashtu edhe ato të qëllimeve të nxjerrjes së materialeve  
25 në bazë të rregullit 103. Dhe kjo është pika tjetër, pra,

1 rishikimi i tyre në një fazë të avancuar, pasi ta përfundojmë,  
2 do t'i japim Mbrojtjes një njoftim për dokumentet që kanë  
3 mbetur.

4 Faleminderit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Meqenëse që nga konferenca  
6 e fundit, ZPS-ja ka nxjerrë shtatë paketa me materiale  
7 potencialisht shfajësuese dhe po përgatiten materiale të  
8 tjera. Dhe gjatë ditëve të fundit, me sa kam marrë vesh, është  
9 edhe një paketë tjetër.

10 Sipas ZPS-së, lidhur me materiale të marra apo të  
11 miratuar deri në 31 janar 2022, rishikimi i materialeve  
12 shfajësuese është bërë më shumë se 70 për qind, me afërsisht  
13 2.500 dokumente të mbetura për t'u caktuar për rishikim  
14 shfajësues.

15 ZPS-ja ka vënë në dukje gjithashtu se nuk ka ndonjë  
16 kërkesë tjetër për masa mbrojtëse të mëtejshme për këtë  
17 kategori.

18 Mbrojtja ka vënë në dukje se përse ky material nuk është  
19 një orë më parë dhe se ai ka një ndikim të drejtpërdrejtë në  
20 përgatitjen dhe hetimet e saj.

21 Në parashtrimet e saj, Mbrojtja e Krasniqit kërkoi  
22 konkretisht që ZPS-ja të konfirmojë të gjithë dokumentet që  
23 thonë apo sugjerojnë se UÇK-ja nuk ka pasur strukturat  
24 komanduese të një ushtrie të rregullt, të gjithë dokumentet që  
25 sugjerojnë se situata në Kosovë pas 12 qershorit 1999, ishte

1 kaotike apo anarkike dhe se të gjithë dokumentet që tregojnë  
2 se z. Krasniqi ka qenë jashtë Kosovës gjatë gjithë kohës së  
3 periudhës së Aktakuzës përfshirë dhe periudhën mars-qershor  
4 1999.

5 Gjithashtu, Mbrojtja e Veselit kërkon që unë të përcaktoj  
6 një afat për përfundimin e materialeve të rregullit 103 gjatë  
7 30 ditëve të ardhshme.

8 U kujtoj palëve, se materialet shfajësuese duhen të  
9 nxirren sipas formulimit të Rregullores po sa më shpejt që  
10 është në ruajtjen, kontrollin apo njohurinë e ZPS-së, pra,  
11 konkretisht e ftoj ZPS-në të na thotë nëse mund të angazhohet  
12 për një afat të përcaktuar lidhur me përfundimin e materialeve  
13 shfajësuese që rishikohen prej tyre.

14 Znj. Prokurore, keni fjalën.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] ZPS-ja po përmbush detyrimet e  
16 saj lidhur me materiale të rregullit 103. Këtë e kemi bërë me  
17 shumë seriozitet që nga fillimi i procedurave, po e bëjmë  
18 rishikimin me vëmendje dhe po i nxjerrim vazhdimisht.

19 Që nga konferenca e kaluar, kemi nxjerrë edhe paketa  
20 shtesë të materialeve të rregullit 103 që përmbajnë 751 prova.

21 Siç kemi vënë në dukje në parashtrimet tona me shkrim,  
22 dhe siç e përmenda para pak kohe, lidhur me materialet e marra  
23 apo të miratuar deri në datën 31 janar 2022, i kemi bërë edhe  
24 70 për qind të rishikimit, që janë afërsisht 2500 prova që  
25 futen në këtë gamë të cilat mbeten për t'u parë lidhur me



1 përmbajtjen shfajësuese të tyre. Në dritën e faktit se ky  
2 rishikim provë pas prove kërkon punë dhe ne, ndërkohë, po  
3 bëjmë dhe kërkime lidhur me listat e dëshmitarëve për t'u  
4 siguruar që të gjithë dokumentet shfajësuese të identifikohen  
5 dhe të nxirren.

6 Dhe tani t'i kthehem shkurt disa çështjeve konkrete të  
7 ngritura në parashtrimet e Mbrojtjes përpara kësaj seance dhe  
8 siç e përmendët dhe ju gjatë hyrjes, në paragrafin 13 të  
9 parashtrimit të Mbrojtjes së Krasniqit, përmenden dy kategori  
10 dokumentesh që ju i parashtruat. Mbrojtja ka ngritur një  
11 pyetje me ne lidhur me këto kategori në fund të javës që shkoi  
12 dhe ne u përgjigjëm të martën. Në parashtrim shohim se ajo  
13 është hartuar si kërkesë për informacion që të gjitha  
14 dokumentet që janë në këtë kategori të jenë nxjerrë, por, siç  
15 keni parasysh, ne i kemi dhënë të gjitha ekipeve të Mbrojtjes  
16 një përditësim të statusit dhe të gjendjes së rishikimit dhe  
17 aty vumë në dukje se ka ende dokumente që duhen rishikuar. Nuk  
18 e di nëse është një pyetje serioze sepse të cilës nuk mund t'i  
19 jepet përgjigja para se të bëhet rishikimi.

20 Lidhur me kërkesën për një afat, nuk kisha për qëllim ta  
21 trajtoja këtë gjerë e gjatë, parashtrojmë se Mbrojtja e  
22 Veselit nuk duhet lejuar ta bëjë këtë. Kur në seancën e  
23 fundit, ju na udhëzuat që gjithçka të bëhet me shkrim për të  
24 lehtësuar vendimmarrjen dhe informimin e duhur. Dy nga ekipet  
25 e Mbrojtjes, e Krasniqit dhe e Thaçit, e kanë bërë këtë dhe

1 një nga mjetet e kërkuara ishte afati. Dhe Mbrojtja e Veselit  
2 ka pasur mundësi të bëjnë parashtrime të tjera të rëndësishme  
3 lidhur me këtë kërkesë, por ata zgjodhën të mos e bënin dhe në  
4 vend të kësaj parashtruan një kundërpërgjigje të shkurtër.

5 Për ne është e paqartë se cili është qëllimi, nëse është  
6 një shtesë e atij diskutimi apo është një kërkesë e veçantë.  
7 Gjithsesi, për ne na duket e pavend që të vijmë këtu para një  
8 jave që duhej bërë ky parashtrim dhe të lejohet të bëhet kjo  
9 shtesë dhe kjo bie ndesh dhe me udhëzimin që fillimisht çdo  
10 çështje duhet informuar me shkrim.

11 Nëse mendohet se është një kërkesë paralele është edhe më  
12 e papërshtatshme. Që të kërkohej të rishqyrtohet e njëjta  
13 çështje përsëri, shkon gati në abuzimin e procesit.

14 Megjithatë, për sa i takon pyetjes suaj se kur ne do të  
15 përfundojmë rishikimin tonë lidhur me rishikim zë për zë të të  
16 gjitha dokumenteve, ne parashikojmë që kjo do të përfundojë,  
17 mendojmë, deri në konferencën e ardhshme. Nëse të gjithë  
18 dokumentet e identifikuar do të jenë përpunuar dhe nxjerrë  
19 plotësisht nuk është diçka që mund ta konfirmoj tani.

20 Megjithatë, përveç rishikimit zë për zë, siç thashë, ne  
21 po bëjmë dhe kontrole të synuara si një masë shtesë për t'u  
22 siguruar që materialet të identifikohen dhe të nxirren. Dhe ne  
23 parashikojmë që nxjerrjet e më tejshme do të burojnë nga këto  
24 kërkime, megjithatë, sot nuk jam në gjendje të jap një  
25 vlerësim për këtë aspekt të rishikimit duke pasur parasysh se

1 marrim mijëra kërkime për një emër të caktuar, të cilët duhet  
2 t'i verifikojmë. Po ndërkohë duhet t'ju mbajmë të informua për  
3 ecurinë tonë.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar. E kam vënë re se  
5 shumë nga parashtrimet e ZPS-së thuhet se janë "të plota". Nuk  
6 e di nëse janë kështu apo jo. Bëhet fjala për mijëra dokumente  
7 shfajësues, sikurse ju me të drejtë e vutë në dukje, kur janë  
8 në ruajtjen, kontrollin apo njohurinë e ZPS-së. Ruajtjen dhe  
9 kontrollin kjo të tregon që duhen nxjerrë menjëherë. Posa që  
10 klientët tanë erdhën këtu në nëntor të 2020 ai proces nëse  
11 dokumentet kanë qenë në zotërimin e tyre, duhet të ishte bërë  
12 ky proces menjëherë, menjëherë. Dhe ju, i nderuar Gjykatës, e  
13 qortuat ZPS-në, në një konferencë përpara kësaj të parafundit,  
14 që nuk i kanë nxjerrë materialet shfajësuese 103 si duhet dhe  
15 menjëherë dhe ju këmbëngulët që kjo të bëhej menjëherë.

16 Unë jam i shqetësuar në nivele të ndryshme se kjo gjë nuk  
17 është bërë dhe vazhdon të mos bëhet. Dhe shumë mirë mund të  
18 ndodhë dhe ne do ta trajtojmë paksa këtë çështje, për shkak të  
19 qasjes disi prej miopi që po ndjekë ZPS-ja lidhu me materialet  
20 e rregullit 103. Që nuk janë vetëm materiale shfajësuese por,  
21 me rëndësi, janë informacione që kanë të bëjnë me  
22 besueshmërinë, kredibilitetin e provave të Prokurorit të  
23 Specializuar. Edhe pse nuk përmenden emrat e këtyre katër  
24 zotërinjve, kjo prek edhe kredibilitetin e provave të çështjes  
25 së Prokurorisë dhe këto futen në rregullin 103. Unë do ta

1 shpjegoj më me hollësi.

2 Por të flasim pak për aspektin e menjëhershëm të gjërave,  
3 Gjykatës, çdo të thotë menjëherë apo kur nxirren gjërat. Ne  
4 pamë më në fund paketën në bazë të rregullës 103 dhe u jam  
5 mirënjohës për këtë, bëhet fjalë për ambasadorin Everts dhe  
6 një zotëri tjetër i respektuar, [REDAKTUAR] në Prishtinë,  
7 i quajtur, informacioni i të cilit u dorëzua në bazë të  
8 rregullës 103 ishte intervista e tij e 103 që, në fakt, është  
9 shfajësuese.

10 Po të shohim këtë intervistë, ajo është marrë nga ZPS-ja  
11 në 17 shtator 2020. 17 shtator dhe ne e kemi marrë në 1 shkurt  
12 të vitit 2022. 16 muaj më vonë.

13 Unë e kuptoj që në rastin e disa dokumenteve ka disa  
14 probleme lidhur me miratimin e rregullit 107. Po këtu nuk  
15 ishte një çështje e tillë për këtë intervistë. Dhe unë e  
16 kuptoj që ka çështje që kanë të bëjnë me përkthimin për  
17 shembull. Këtu, në këtë rast, nuk ishte kjo çështje lidhur  
18 pra, me intervistën e [REDAKTUAR]. Sepse është bërë në  
19 anglisht. Dhe unë e kuptoj se mund të ketë ndonjë problem, për  
20 shembull, që njerëzit s'kanë njohuri konkrete sesa shfajësues  
21 mund të jetë ky informacion? S'e kemi as këtë sepse znj.  
22 Lawson e ka bërë intervistën.

23 Pra, çfarë arsye të mundshme mund të ketë që klientët  
24 tanë rrinë në burg dhe presin pothuaj 16 muaj derisa të bëhet  
25 i njohur ky material i rregullit 103? Unë nuk më vjen në

1 mendje asnjë arsye. Ata e dinin, e dinin prej shumë kohësh dhe  
2 zgjodhën të mos na e jepnin ne për të keqen e klientëve tanë  
3 dhe në fakt, Gjykatës, për të keqen e Gjykatës, pra, në dëm të  
4 Gjykatës. Sepse shumë prej këtij informacioni, po të lëmë  
5 mënjane gjyqin, ku paraqiten shumë argumente sepse klientët  
6 tanë duhen liruar dhe shumë prej këta shkuan, flasin për  
7 dobësinë e çështjes së Prokurorisë, çfarë do të ndodhte nëse  
8 katër këta zotërinj do të liroheshin. Këto çështje janë të  
9 pavërtetuara.

10 Çështja retorike është: Ju nuk doni që ne ta dimë, ta  
11 marrim këtë dokument shfajësues? Sigurisht, kur të merrni  
12 vendim për lirimin e parakohshëm? Sigurisht, Gjykata dhe Trupi  
13 Gjykues duhet të jetë gjithmonë i mirinformuar. Nuk ka  
14 justifikim për këtë.

15 16 muaj, pra, që kur është bërë kjo intervistë. Më shumë  
16 se një vit e gjysëm që klientët tanë rrinë në gjyq dhe kjo  
17 pritet aty dhe neve e marrim vetëm 16 pas faktit? Ky është  
18 udhëzimi në bazë të të cilit ne punojmë sipas ZPS-së? Nuk mund  
19 të ndodhë kështu, nuk mund të ndodhë, parashtroj përpara jush.

20 Ky është një aspekt që është jashtëzakonisht shqetësues  
21 lidhur me analizën në bazë të rregullit 103 që po bëhet nga  
22 ZPS-ja, që është edhe një nga arsyet pse kemi kërkuar për një  
23 palë të pavarur ta rishikojë këtë çështje, por kjo është një  
24 gjë tjetër.

25 Pika e dytë. Ka pasur qindra dëshmitarë të UÇK-së që me

1 sa duket janë intervistuar. 83 syresh që janë nxjerrë. Nuk ka  
2 materiale të rregullit 103 në të gjithë njëqind e ca  
3 dëshmitarët që janë intervistuar nga ZPS-ja? Sepse ne nuk kemi  
4 marrë asgjë. Ne kemi marrë 83, por një qind e ca që janë  
5 intervistuar përveç asaj. E di që disa prej tyre zgjodhën të  
6 mos dëshmonin, si mbas të drejtës së tyre. Po jo të gjithë. Jo  
7 të gjithë aspak jo të gjithë. Ku janë ato deklarata, numri  
8 një; numri dy, nuk materiali në asnjë prej rregullit 103 në  
9 ato? Asnjë informacion që ka të bëjë me kredibilitetin e ZPS-  
10 së? Sigurisht që ka.

11 Ne e kemi thënë dhe herës tjetër që nuk janë nxjerrë  
12 shumë dëshmitarë, siç është z. Bukoshi, ish-ambasadori Avni  
13 [Spahu].

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk duhen përmendur emrat e  
15 njerëzve me të cilët ne kemi pasur kontakt. Kërkojmë që të  
16 redaktohen.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Z. Spahiu nuk është dëshmitar i  
18 Prokurorisë. Nuk ka masa mbrojtëse për z. Bukoshi.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk duhen përmendur emra  
20 për qëllimin e paraqitjes së çështjes suaj.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] E kuptoj. Po vazhdoj pa përmendur  
22 emra.

23 Prova, dëshmi që kanë të bëjnë me kredibilitetin  
24 besueshmërinë e provave të ZPS-së. Nuk kemi marrë asnjë  
25 informacion për operacionet serbe në vjeshtë, ku përveçse të

1 një operacioni -- me operacionin Flamur i Rremë. Ne nuk kemi  
2 marrë informacion. Mos kjo e cenon çështjen e ZPS-së. Pikë së  
3 pari, ZPS-ja po merr, po ka të bëjë me shërbimin e fshehtë  
4 serb, nga i cili ka marrë shumë materiale apo nga të cilët ka  
5 dëgjuar, ka marrë shumë akuza. Akuza të cilat shyqyrisht që  
6 nuk e gjetën rrugën deri në Aktakuzë që bashkëpunoi me Rusinë  
7 se ç'po ndodh në Ukrainë, po kjo është një gjë tjetër.

8 Pra, gjithë, pra, po merr, siç thashë, informacion, prova  
9 nga serbët të cilat pa dyshim që do ta cenonin kredibilitetin  
10 e ZPS-së.

11 Për sa i takon çështjes dhe po i kthehem një komenti të  
12 ZPS-së lidhur me mendimin e dy -- për materialet e rregullit  
13 103(2), ishte një letër nga Departamenti i Shteteve të  
14 Bashkuara që i drejtohej kryetarit të Komitetit të Punëve të  
15 Jashtme, ku është thënë që nuk ka pasur ndonjë kontroll,  
16 komandë efikase të UÇK-së në Kosovë. Dhe përgjigja e tyre  
17 është: Ne i kemi kërkuar kontrolluar ato dosje dhe është aty.  
18 Ato kanë bërë kërkesa në Amerikë drejtuar qeverisë amerikane  
19 për vite, ka vite që e bëjnë këtë dhe nuk kanë bërë asnjë  
20 kërkesë për asnjë dokumentacion që kishte të bënte që të  
21 cenonte hetimin, kredibilitetin e hetimit të tyre dhe thonë se  
22 nuk i kam pasur.

23 A e di njeri këtë gjë që ato kanë kërkuar dokumente nga  
24 Amerika, nga Shtetet e Bashkuara? I di njeri dokumentet e  
25 tyre, është marrë ndonjë vendim që nuk duan t'i marrin këto

1 dokumente?

2 Kjo është një shkelje e rregullit 103. Dhe nuk është i  
3 vetmi dokument. Është dhe një raport i CIA-s, i 3 janarit  
4 2000, CIA publikisht i drejtohet Kongresit në rastin e  
5 diskutimit të një projektligji për buxhetin.

6 Shtetet e Bashkuara konstatuan thotë këtu "UÇK", që  
7 udhëheqja e UÇK-së duket se nuk është angazhuar në operacione  
8 narkotike për të mbështetur aktivitetet e veta gjatë luftës.  
9 Kjo ka ardhë nga Agjencia e Zbulimit Amerikan.

10 Kanë thënë gjithashtu: Që UÇK-ja nuk është përfshirë në  
11 aktivitete terroriste të përcaktuara si dhunë e paramenduar e  
12 kryer kundër objekteve joluftarake.

13 Pra, thonë që nuk e dinë këtë raport, ku thuhet se s'ka  
14 pasur trafik dhe udhëheqja nuk është përfshirë në aktivitete  
15 terroriste? Përsëri po ndjekim një qasje miope se çdo të thotë  
16 materiale të rregullit 103. Këtu duhet ta hapim horizontin  
17 tonë lidhur me atë që është material i rregullit 103. Dhe  
18 testi duhet të ishte nëse jua cenon çështjen atyre, po t'i  
19 lëmë më mënjane këta persona, ata duhet të na japin neve këto  
20 materiale. Ky është shqetësimi ynë. Me gjithë respektin e  
21 duhur, është një shqetësim që duhet rregulluar, duhet ndrequr,  
22 që ky informacion duhet dorëzuar menjëherë dhe jo të pritët 16  
23 muaj e pastaj të dorëzohet.

24 Dhe unë parashtroj, ju drejtohem juve, që të na ndihmoni  
25 që kjo gjë të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, sot, jo



1 kur ata vendosin të na i japin pak nga pak dhe të vijnë këtu  
2 dhe të thonë kryesisht në masën, pjesën më të madhe ka  
3 përfunduar.

4 Ç'domethënë kjo në pjesën më të madhe ka përfunduar? Kur  
5 do të përfundojë plotësisht? Dhe, siç tha kolegu im, lidhur me  
6 kërkesat e rregullit 103, të gjitha këto mosnxjerrje kanë  
7 ndikuar tek ajo që ne nuk kemi mundur të bëjmë lidhur me  
8 hetimet tona. Sepse ne jemi penguar jashtëzakonisht shumë në  
9 hetimet në intervistat, në dokumentet e kërkuara nga palët e  
10 treta, të gjitha dokumentet me të cilat del ky informacion.

11 Faleminderit shumë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

13 Znj. O'Reilly.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Kam një gjë  
15 për të thënë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, z. Emerson.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë harrova  
18 në fillim që të prezantoja në fillim që të prezantoja dy  
19 kolegë. Një është Kujtim Kerveshi, që është shef i hetimeve  
20 dhe tjetri është Andrew Strong, që është mbrojtësi që  
21 këshillon hetimet.

22 A mund t'ia jap fjalën z. Strong që të bëjë parashtrimet  
23 tona sa i takon materialit të rregullit 103?

24 Dhe unë u bëj jehonë edhe fjalëve që jua drejtoi z.  
25 Kehoe. Ka shumë lloje provash të cilat gjenden në domenin

1 publik dhe të cilat konfirmojnë ato lloj manipulimesh të  
2 provave nga ana e autoriteteve serbe, siç është përfshirë këtu  
3 edhe zhvarrosjen e varreve masive të viktimave dhe të atyre që  
4 janë transportuar në kufi me Serbinë, ku është gjendur një  
5 kamion, për shembull, diku edhe afër Danubit dhe po kështu  
6 rivendosja e kufomave nga ana e policisë, pra, në territorin  
7 serb.

8 Pra, është kryer një operacion pastrues në masë të gjerë  
9 që tregon dhe manipulimin e provave edhe është në burim të  
10 hapur sepse është folur gjatë për këtë në gjykimet e TPNJ-së.  
11 Serbët kanë përdorur një sërë taktikash për të marrë  
12 informacione të rreme dhe prova të rreme, përfshirë këtu edhe  
13 torturën, shantazhin edhe të ngjashme, të cilat janë të gjitha  
14 materiale shfajësuese dhe të cilat duhet të ishin përfshirë  
15 tek analiza që i ka bërë ZPS-ja sidomos në materiale që vijnë  
16 nga shërbimi informativ serb.

17 Por, në përgjithësi, këto ishin fjalët e mia. Dua t'ia  
18 jap fjalën tani z. Strong sa i takon aspektit të nxjerrjes së  
19 dokumenteve.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Strong, keni fjalën.

22 Z. STRONG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

23 Kemi kërkuar afat tani sepse në dy konferencat e fundit  
24 për ecurinë e çështjes, i kemi kërkuar ZPS-së që të japë  
25 çmuarjen e vet më të mirë sa i takon afatit se kur do ta

1 përfundojë shqyrtimin sa i takon rregullit 103. Në konferencën  
2 e fundit për ecurinë e çështjes, i nderuar Gjykatës, i kërkoj  
3 ZPS-së që të jepte përgjigje kësaj. Është në faqen 896,  
4 rreshti 3, të transkriptit.

5 Unë ende nuk kam dëgjuar një vlerësim nga ana e ZPS-së se  
6 kur mund ta marrin këtë material. Ne thjesht dëgjojmë deri në  
7 konferencën e ardhshme për ecurinë e çështjes do të ketë edhe  
8 do të eci përpara shqyrtimi e tjerë. Mirëpo, me ecjen përpara  
9 në kohë, duhet të na jepet mundësi që ta kemi këtë informacion  
10 edhe të planifikojmë Mbrojtjen por nuk e kemi këtë në dorë,  
11 atëherë nuk bëjmë dot gjë.

12 E kuptojmë, problemi kryesor i ZPS-së është që kërkon  
13 shumë kohë dhe kërkon që ato të bëjnë një shoshitje të mijëra  
14 dokumenteve. E kuptoj këtë sasi të madhe informacioni sepse  
15 dhe neve na duhet që ta shoshitim gjithë këtë informacion, por  
16 kjo shërben edhe si një tregues që volumi i kësaj çështjeje  
17 gjyqësore është tepër i madh, më tepër nga ç'duhet. Sepse deri  
18 tani, që kanë kaluar kaq shumë muaj, të kemi arritur vetëm 70  
19 për qind, kjo do të thotë se ka diçka që nuk shkon. Nëse bëjmë  
20 disa veprime aritmetike, nëse janë dashur 16 muaj për të bërë  
21 70 për qind të kësaj shoshitje, u dashkan edhe shtatë muaj të  
22 tjerë për ta përfunduar. Prandaj dhe ne mendojmë, i nderuar  
23 Gjykatës, që nevojitet një afat.

24 Ka dhe diçka të dytë, duket sikur ka dy kategori të  
25 ndryshme provash. Një janë databazat ekzistuese, në të cilat

1 duhet të bëjë kërkime ZPS-ja, besoj se janë informacione të  
2 mëdha të cilat i kanë trashëguar nga EULEX-i apo nga qeveri  
3 bashkëpunuese. Këto informacione duhet që të kalojnë përmes  
4 proceseve që ka ZPS-ja, sigurisht, këto janë shumë të mëdha  
5 dhe prandaj dhe kërkon kohë.

6 Por ka edhe një kategori të dytë informacionesh, të cilat  
7 vetë ZPS-ja i ka krijuar, për shembull, kur ka një intervistë,  
8 ku është e pranishme vetë ZPS-ja dhe dëshmitari ka dhënë  
9 informacion shfajësues. Në rastin e kësaj kategorie, mua më  
10 duket procesi shumë i thjeshtë që ky informacion t'i nxirret  
11 Mbrojtjes. E megjithatë është pikërisht informacioni që kemi  
12 marrë gjatë gjashtë javëve të fundit, informacion i cili është  
13 marrë para tre vjetësh. Kështu që unë nuk e kuptoj, në rastin  
14 e kësaj kategorie, sesi ka mundësi që u është dashur tre vjet  
15 që këta prokurorë, që kanë qenë aty të pranishëm në dhomë, kur  
16 e kanë marrë këtë informacion shfajësues t'ia japin Mbrojtjes,  
17 siç e thashë, vetëm pas tre vjetësh. Prandaj nuk është e  
18 kuptueshëm nga ana jonë.

19 Për të gjitha këto arsye, ne themi që ka diçka që nuk po  
20 funksionon me efikasitet që ky informacion që nxirret, i  
21 nderuar Gjykatës, ka theksuar se është informacion me rëndësi  
22 kritike për Mbrojtjen. Është objektivi ynë kryesor sepse, në  
23 bazë të saj, ne ngremë strategjinë e Mbrojtjes dhe  
24 parashikojmë dhe cilat do jenë provat e Mbrojtjes.

25 Për këto arsye, i nderuar Gjykatës, ne parashtrojmë se

1 koha po kalon dhe se na nevojitet një afat.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shumë shkurt, ju lutem,  
3 sepse nuk mund të flasim të gjithë anëtarët e ekipit.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]  
5 Faleminderit. Unë mendoj, se ajo që thanë z. Kehoe dhe z.  
6 Strong, përpiqen të nënvijëzojnë këtë se ka gjëra të cilat çdo  
7 prokuror që ndodhet, që merr pjesë në këtë proces, mund të  
8 jetë në dijeni të informacioneve që ato i kanë parë po që kanë  
9 dalë në procese të tjera.

10 Për shembull, prova të forcave serbe në terren, në  
11 Kosovë, kanë pasur në dispozicion municione kineze për ta bërë  
12 situatën - pra, për të vrarë civilë dhe kjo do të dukej sikur  
13 kjo ishte bërë nga UÇK-ja.

14 Pra, ka orvatje serioze nga ana serbe për të manipuluar  
15 provat. Ky informacion dihet. Pse nuk na është vënë në  
16 dispozicion? Dhe ne shpresojmë që ky 30 për qindësh,  
17 domethënë, që nuk është shoshitur ende apo që nuk po nxirret,  
18 mund të jenë gjëra kaq të dukshme që mund të na nxirren. Kjo  
19 mund të lidhet drejtpërdrejtë me Aktakuzën dhe me sa duket  
20 ende nuk është përfunduar.

21 Nuk na është vënë në dispozicion se është në këtë 30  
22 përqindëshin që ka mbetur. S'e besojmë që të jetë kështu. Ose  
23 do të tregonte që metoda që ka ndjekur Prokuroria për të bërë  
24 nxjerrjen e këtij materiali nuk ka qenë rigorozë sepse ka  
25 materiale që ato nuk i kanë nxjerrë apo i kanë nxjerrë me

1 vonesë që kanë qenë shumë të thjeshta për t'u vlerësuar.

2 Ka diçka që nuk shkon vërtet këtu. Çdo pyetje që ju mund  
3 të bëni sa i takon hetimeve të Mbrojtjes, të dosjes paraprake  
4 të Mbrojtjes e tjerë, neve na mbetet të shohim se çka mbetur  
5 në këtë 30 përqindësh dhe pastaj të kuptojmë pse nuk e na e  
6 paskan nxjerrë këtë material të cilin e dinin që më përpara, i  
7 cili duhej të ishte nxjerrë.

8 Pra, kjo kërkon një datë ndarëse në mënyrë decizive. Ne  
9 duam që Prokuroria të përshpejtojë shumë nëse duam që procesi  
10 të fillojë në një moment në të ardhmen e parashikueshme a në  
11 të ardhmen e afërt.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. Young, ju lutem.

14 Z. YOUNG: [Përkthim] Njësoj si edhe kolegët tanë, kemi  
15 shqetësime të rënda sa i takon qëndrimin që mban Prokuroria  
16 për nxjerrjen e materialit shfajësues. Siç e dimë shumë mirë,  
17 ky material ka të bëjë me pafajësinë e të akuzuarve dhe mund  
18 të ndryshojë tërësisht pistën apo mund të ndryshojë edhe  
19 çështjen gjyqësore.

20 Duhet ta analizojmë ato që ka argumentuar Prokuroria apo  
21 që ka thënë. Në paragrafin 8 të parashtrimit të tyre me  
22 shkrim, i thonë të nderuarit Gjykatës se shqyrtimi ka mbaruar,  
23 më shumë se 70 për qind i shqyrtimit, ku mbeten dhe 2500  
24 materiale të tjera për shqyrtim shfajësues.

25 A mund të kuptojmë se ç' do të thotë kjo. Sepse kështu,

1 siç është shkruar këtu, mua më duket se deri tani ata e kanë  
2 shqyrtuar këtë material, pra, 70 për qind material e kanë  
3 shqyrtuar, kanë marrë një vendim për këtë që është shfajësues  
4 dhe duhet nxjerrë, atëherë pse nuk e nxjerrin që tani?

5 Mbase e kam kuptuar unë gabim atë që kanë shkruar, atë që  
6 ka shkruar Prokuroria, por edhe pse e kanë finalizuar, e kanë  
7 përmyllur qëndrimin e tyre për 70 për qind të materialit, i  
8 cili është shfajësues dhe është i rëndësishëm për Mbrojtjen,  
9 ato na thonë që nuk do t'ua nxjerrim tani, që është shkelje  
10 flagrante e Rregullores. Dhe Rregullorja ka një qëllim. Sepse  
11 ato thonë që dale njëherë se kemi dhe 2500 materiale të tjera.  
12 Kështu që do t'jua vonojmë nxjerrjen e asaj që duhet të ishte  
13 nxjerrë tani deri sa të përfundojmë edhe këto 2500 të tjera.  
14 Nëse unë e kam kuptuar gabim, atëherë kjo është shumë  
15 shqetësuese.

16 E mbështes shumë atë që thotë z. Kehoe sidomos sa i takon  
17 provave që kanë të bëjnë me UÇK-në të cilat ende mbeten të  
18 panxjerra deri tani.

19 Nëse është e saktë teoria e z. Kehoe, duket se ka një  
20 tërësi të konsiderueshme të provave të UÇK-së të cilat nuk  
21 janë nxjerrë fare. Dhe kjo është e rëndësishme të shikojmë  
22 këtë, sesi quhen këto prova, po edhe sesi nuk quhen. Nëse  
23 ekzistojnë këto prova, pra, si materiale të rregullit 103, për  
24 një tërësi të madhe të anëtarëve të UÇK-së, atëherë është  
25 diçka e cila duhet nxjerrë menjëherë.

1 Sa u takon çështjeve të tjera, unë nuk po sugjeroj që  
2 duhet të këtë ndonjë datë ndarëse përfundimtare për materialin  
3 e rregullit 103, ama, nëse e kanë tani, ta nxjerrin menjëherë.  
4 Që sot.

5 Sigurisht, në të ardhmen, nëse ato bëjnë shqyrtime të  
6 tjera, nëse zbulojnë materiale të tjera të cilat bëjnë pjesë  
7 tek ky rregull, atëherë mund të na i nxjerrin më vonë. Por ajo  
8 që përpiqem të themi është se s'ka asnjë arsye pse duhet të  
9 bëjnë shtyrje në kohë dhe nëse duhet t'u kërkojmë llogari  
10 Prokurorisë sipas Rregullores së procedurës, ka vetëm një  
11 përgjigje mendoj unë.

12 Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

14 Do t'i them Prokurorisë që t'i përgjigjet pyetjes suaj  
15 sidomos për paragrafin 8 të parashtrimeve me shkrim të  
16 Prokurorisë, nëse ka një vonesë për të nxjerrë materialin  
17 shfajësues në pritje të 2500 materialeve tjera. Se unë nuk e  
18 interpretoj kështu, por më mirë të përgjigjet vetë Prokuroria  
19 dhe ta konfirmojë.

20 Z. Ellis, keni fjalën.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Të nderuar  
22 Gjykatës, pak dua të them ca fjalë sa i takon problemit të  
23 kohës, unë e di, që ka parashtrime me shkrim të cilat i janë  
24 drejtuar, të nderuarit Gjykatës. Por, tek e fundit, jemi në  
25 konferencën për ecurinë e çështjes dhe rregulli 103 është



1 pikërisht një pikë e rendit të ditës e cila gjithashtu është  
2 për t'u trajtuar.

3 Prokuroria thotë se ka nxjerrë 750 materiale muajin që  
4 shkoi, në bazë të rregullit 103. Kjo nuk tregon që ato po e  
5 kryejnë në mënyrë korrekte këtë detyrim se kanë kaluar 16 muaj  
6 tashmë në këtë proces. Kjo sasi, që ata vazhdojnë të nxjerrin,  
7 tregon një problem që ka diçka që nuk funksionon.

8 Sa i takon të ardhmes, ato na thonë se po bëhen kontrolle  
9 zë për zë të cilat ZPS-ja mendon se do t'i përfundojë deri në  
10 konferencën e ardhshme të konferencës për ecurinë e çështjes,  
11 që është më 15 [sipas përkthimit] maj, shtatë javë.

12 Sa i takon këtyre kontrolleve të synuar të cilat na u  
13 paraqitën në parashtrimet e bëra gojarisht sot. Çfarë janë  
14 këto kontrollet e synuara? Pse nuk i kanë bërë më përpara?  
15 Edhe sa kohë do të na duhet të presim për këto? Pastaj duhet  
16 të mendojmë mirë kur flasim për kohën.

17 Folëm sot për procesin e rregullit 102(3). Nëse shikojmë  
18 që 5000 dokumente përpunohen në javë për këtë, ka 14.000  
19 dokumente që mbeten pa u parë vetëm për Mbrojtjen e Krasniqit.  
20 Kështu që, janë shumë javë. Dhe po t'i shtojmë kësaj edhe  
21 shumë dokumente të tjera, me mijëra dokumente të tjera, që  
22 kërkojnë kolegët e tjerë, kjo përbën një problem të madh.  
23 Sepse z. Krasniqi dhe të tjerët janë ende në paraburgim. Duan  
24 që kjo çështje të ecë përpara. Dhe nxjerrja është problematike  
25 në të gjitha këto aspekte, prandaj dhe kërkohen afatet për

1 këtë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

3 Znj. Prokurore, ju kërkoj që t'u përgjigjeni të katër  
4 ekipeve të Mbrojtjes, dua gjithashtu që të bëni të ditur nëse  
5 keni ndonjë mospajtim material sa i takon objektit të  
6 materialit shfajësues. Sepse disa ekipe të Mbrojtjes kanë  
7 parashtruar si material të rregullit 103 materiale, prova të  
8 cilat ka gjeneruar vetë ZPS-ja, por u përmendën këtu edhe  
9 prova të cilat do të duhet të ishin nxjerrë sepse në  
10 përgjithësi përmendin UÇK-në, apo kanë të bëjnë me UÇK-në dhe  
11 për pasojë mund t'i jepni Mbrojtjes një lloj prove sa i takon  
12 vlerësimit të UÇK-së, por edhe u ngrit edhe çështja e  
13 kontrolleve proaktive nga ana e ZPS-së për prova të mundshme  
14 shfajësuese dhe këtu, në veçanti, e kam fjalën për atë tha z.  
15 Kehoe për disa dokumente.

16 Nuk e di nëse keni disa mendime për objektin e detyrimit  
17 tuaj këtu.

18 Keni fjalën.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Së pari, ne jemi të vetëdijshëm  
20 për detyrimet e rregullit 103. Nuk mendojmë se ka ndonjë  
21 mosmarrëveshje sa i takon objektit të kësaj rregulle. Nuk ka  
22 asgjë për t'u ndrequr, sipas mendimit tonë.

23 Dhe në këtë rast, sa i takon disa gjërave konkrete që u  
24 përmendën për shembull, nga Mbrojtja e Veselit, siç është  
25 municioni me prodhim kinez, në fakt, janë gjëra të cilat edhe

1 mund të na kenë - pra, nuk kam materiale të cilat na kanë  
2 shpëtuar nga shqyrtimi.

3 Sa i takon parashtrimeve fillestare të cilat bëri  
4 Mbrojtja e Thaçit, nxjerrja shfajësuese bëhet në raport me  
5 akuzat e konfirmuara në Aktakuzë me të akuzuarit e veçantë,  
6 pra, bëhet në lidhje me Aktakuzën dhe duke mbajtur parasysh  
7 edhe regjimin e masave mbrojtëse që është i zbatueshëm për  
8 këtë çështje gjyqësore.

9 Në këtë kornizë kemi punuar për një tërësi të madhe  
10 materialesh, të cilat ne i kemi nxjerrë në vazhdimësi, në  
11 përputhje me kornizën dhe me udhëzimet e dhëna.

12 Nxjerrja e 751 materialeve pas konferencës së fundit për  
13 ecurinë e çështjes u prezantua këtu si një lloj treguesi  
14 vonese po nuk është kështu. Sepse ne kemi qenë konsekuent në  
15 nxjerrjet tona. Kemi marrë, kemi treguar që kemi vepruar me  
16 korrektësi. Në dhjetor kemi nxjerrë mbi 1300 materiale. Më  
17 shumë sesa në periudhën e fundit. Në periudhën gjashtë mujore  
18 qershor-korrik kemi nxjerrë 754 materiale. Pra, ne gjithmonë  
19 përpiqemi që t'i nxjerrim sa më shpejt, përpjekjet tona kanë  
20 qenë konsekuente dhe nxjerrjet kanë qenë të njëtrajtshme me  
21 njëra-tjetrën.

22 Pra, parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit sa i takon  
23 kontakteve me qeverinë amerikane dhe shkalla e bashkëpunimit  
24 apo e materialit që mund të kemi marrë është tërësisht  
25 spekulative. Nuk ka absolutisht asnjë bazë të mendosh se ZPS-

1 ja ka akses apo ka në zotërim dokumentacione ashtu siç  
2 sugjeron ajo, Mbrojtja.

3 Një prej ekipeve të Mbrojtjes të paktën përmendi ndarjen  
4 në 70 për qind dhe 30 për qind në një mënyrë e cila besoj se  
5 është çorientuese apo e kanë keqkuptuar informacionin që kemi  
6 bërë ne. Nuk është 30 për qind e gjithë tërësisë sonë që  
7 mbetet për t'u shqyrtuar. Aty përmendim vetëm material të  
8 cilin e kemi marrë, ka marrë dhe miratimin në gjysmën e dytë  
9 të vitit që shkoi deri në 31 janar të 2021.

10 Në mënyrë të ngjashme emrat dhe kontrollet e synuara nuk  
11 përmenden për herë të parë këtu apo parashtrimet tona me  
12 shkrim. Është përmendur edhe në seancat e mëparshme dhe në  
13 parashtrimet e mëparshme të protokolluara diçka që ne e kemi  
14 nisur në përputhje me përmbylljen e listave tona të  
15 dëshmitarëve dhe të provave.

16 Tjetra që është ngritur nga Mbrojtja e Veselit është  
17 objekti i çështjes gjyqësore, por kjo nuk ndikon tek objekti i  
18 materialit që neve na duhet të shqyrtojmë për përmbajtje  
19 shfajësuese.

20 Dhe, në fund, dëshiroj që të bëj një kërkesë procedurale  
21 për të ardhmen. Po nxjerrim me mijëra materiale. Nëse Mbrojtja  
22 e Thaçit apo ndonjëra prej ekipeve të tjera të Mbrojtjes synon  
23 që të flasë për materiale të caktuar, do të kërkonim që të  
24 jepnin një njoftim më të mjaftueshëm për të bërë diskutim  
25 kuptimplotë. Herën e fundit, Mbrojtja e Thaçit shprehu që nuk

1 e kishim dhënë këtë njoftim paraprak pavarësisht nga kontaktet  
2 *inter partes*, paraprakisht, ne mendojmë që këto janë taktika  
3 të padrejta. E bëjnë ose sepse nuk duan që të jenë të  
4 verifikueshme ato që thuhet apo nuk e di për ç'arsye të tjera.  
5 Ne kërkojmë, të nderuar Gjykatës, që në të ardhmen nëse do  
6 jepen detaje të tilla apo diskutime të hollësishme për  
7 materiale konkrete, kërkojmë që të jepet njoftim i mjaftueshëm  
8 për hir të diskutimeve të kuptimita.

9 Në fund, sa i takon aktualitetit për rëndësinë që kanë  
10 materialet sa i takon paraburgimit, ato që thuhet këtu nuk  
11 janë të sakta.

12 Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.  
14 Prokurore.

15 z. Kehoe, shumë shkurt.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Më kanë tronditur ato që sapo pranoi  
17 ZPS-ja. Në dallim nga deklaratat e tyre që nuk duan të bëjnë  
18 diskutim për rregullin, duken që duan ta bëjnë një gjë të  
19 tillë. Dhe krejt menjëherë duket se nuk e përdorin fjalën  
20 "menjëherë" edhe pse është pjesë e detyrimit të tyre për  
21 nxjerrje. Këta persona, që ato nuk duan t'i përmendin me emra,  
22 janë njerëz të shquar. Nuk është ndonjë fshatar i humbur në  
23 ndonjë vend të largët, nuk e di se çfarë. Janë persona të  
24 njohur, që mund të dallohen menjëherë. Emrat nuk duhen  
25 redaktuar. Edhe prapë, ne këtë informacion nuk e marrim.

1 Individu i parë -- për individin e parë ndoshta e marrim vetëm  
2 pas 16 muajsh.

3 E nderuara kolege, duhet rikujtuar edhe njëherë se çfarë  
4 thotë rregulla, thotë menjëherë, sapo.

5 Por, ajo që është tronditëse është se thonë, që ka një  
6 shkallë spekulimi nga ana e Mbrojtjes se çfarë dokumentesh  
7 mund të kenë marrë nga SHBA-ja. Ne e dimë që kanë bërë kërkesa  
8 për dokumente. E dimë që kanë bërë shumë kërkesa për  
9 dokumente. Dhe Prokuroria tani pranon para Gjykatës se nuk  
10 kanë bërë kërkesë për informacion sa i takon strukturës së  
11 UÇK-së.

12 Duke cituar dokumentin siç duhet, dokumenti thotë:

13 "Për tepër, nuk ka një strukturë politike në Kosovë apo  
14 komandim dhe kontroll efektiv të UÇK-së."

15 Mund t'jua jap edhe njëherë. Këtë e citova edhe herën e  
16 fundit. Po e citoj dhe sot.

17 Ky është qëndrimi i Prokurorisë në kërkimin që bëjnë për  
18 të vërtetën që nuk i kanë bërë këto pyetje kanë kaluar dhjetë  
19 vjet dhe thjesht kanë parë atë që kanë dashur të shikojnë.  
20 Ngrenë aktakuzë kundër këtyre personave të cilët kanë që në  
21 nëntor të vitit 2020 dhe rrinë në burg edhe pse na thoshin që  
22 do ta fillonin gjyqin që në prill a në maj. Po s'po flasim më  
23 për këtë.

24 Seriozisht po thonë që nuk i kanë bërë kërkesë qeverisë  
25 amerikane apo CIA-s apo ndonjë qeverie tjetër për këtë

1 informacion, sa i takon këtyre operacioneve narkotike të UÇK-  
2 së dhe kur CIA pastaj ju është përgjigjur, se s'ka asnjë provë  
3 që të mbështesë këto pretendime. Këto informacione që këta  
4 persona të jenë të përfshirë në aktivitete terroriste. Vetëm  
5 na thoni. Sepse ato kanë arritur në këtë konkluzion në janar  
6 të vitit 2000 që UÇK-ja nuk ka qenë e përfshirë.

7 Dhe ZPS-ja del këtu para gjykatës thotë që këto pyetje  
8 nuk ua paskan bërë? ZPS-ja nuk i paska bërë këto pyetje gjatë  
9 hetimeve të veta? Kështu bëhet kërkimi për të vërtetën? Kështu  
10 kërkohet e vërteta? Jo. Arrin në një konkluzion dhe ke dhe  
11 provat për atë konkluzion. Kështu duhet bërë. Ky është  
12 konkluzioni logjik në të cilin dalim në bazë të asaj që sapo  
13 tha Prokurorja për këtë dokument. Se është tronditëse që nuk e  
14 paskan dhe që nuk e paskan kërkuar as këtë dokumentacion, as  
15 dokumentacione të ngjashme të qeverive të tjera.

16 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Po shikoj që është ngritur në këmbë z. Young.

19 Keni fjalën.

20 Z. YOUNG: [Përkthim] Diçka për të thënë për këtë 70 për  
21 qindëshin. Nuk mu duk se znj. Lawson i dha përgjigje pyetjes  
22 që bëra unë dhe që e urdhëroi, i nderuar Gjykatës, mbase e kam  
23 keqkuptuar unë.

24 Por, siç e kuptoj, kështu siç është shkruar me shkrim,  
25 qëndrimi i ZPS-së thonë që ka përfunduar 70 për qind

1 shqyrtimi. Ça do të thotë kjo? Po thotë Prokuroria që deri  
2 tani kanë përfunduar 70 për qind të shqyrtimit të të gjithë  
3 materialeve të cilat i kanë në kujdestari dhe në kontroll?

4 Nëse znj. Lawson po thotë, që nuk ka asgjë në zotërim apo  
5 në kontroll që, sipas mendimit tonë, që kemi bërë dhe  
6 shqyrtimin nuk është shfajësues, atëherë i lutem znj. Lawson  
7 të konfirmojë sot në sallë, që s'kanë asgjë për të nxjerrë.

8 Sepse thotë se ka edhe rreth 2500 materiale që mbeten që  
9 të caktohen për shqyrtim. Por i kërkojmë të nderuarit Gjykatës  
10 të na ndihmojë që të marrim një përgjigje, se mendojmë se  
11 pyetja jonë s'ka marrë përgjigje.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Z. Young.

13 Znj. Prokurore, do të bëni parashtrime shtesë sa i takon  
14 pyetjes së Mbrojtjes së Selimit?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po. Vërtetë. E kuptoj dhe unë që  
16 harrova të përgjigjem. Ju kërkoj ndjesë.

17 Interpretimi që propozon Mbrojtja e Selimit nuk është i  
18 saktë për parashtrimet e mia. Ne i kemi nxjerrë materialet që  
19 kanë dalë nga shqyrtimi në mënyrë të vazhdueshme dhe paketa e  
20 përfulur tashmë e 1 shkurtit e përmban dhe këtë material që  
21 është shqyrtuar më së fundi dhe është marrë së fundi.

22 Sa i takon parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit, ajo që  
23 po bëjmë ne është shqyrtim sistematik zë për zë. Ne nuk e  
24 bëjmë këtë në bazë të vlerësimit subjektiv të Mbrojtjes së  
25 Thaçit se kush është apo kush nuk është personi i njohur sepse



1 ato nuk janë konkluzione - më falni - kur ju thoni që ky nuk  
2 është konkluzioni i logjikshëm mendoj që është një ngutje në  
3 arritjen e një konkluzioni. Mendoj se e keni parë edhe nga  
4 materiali që e kemi nxjerrë tashmë që ne kemi qenë vërtetë të  
5 interesuar që të merrni informacion sa i takon strukturës së  
6 UÇK-së.

7 Mbrojtja e Thaçit citon një dokument që, siç duket e ka  
8 në dorë, por që ne nuk e kemi dhe përdorimi i kësaj është,  
9 pra, si bazë për të pretenduar që ka shkelje nuk është  
10 konstruktiv.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po. z. Strong, keni fjalën.

12 Z. STRONG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë mbase nuk  
13 e dëgjova mirë, po unë ende nuk e di se çfarë vlerëson  
14 Mbrojtja - më falni - çfarë, si vlerëson Prokuroria se kur  
15 mund t'i kemi neve materialet që mund të na i nxjerrin. Kjo,  
16 mendojmë ne, e bën të nevojshme vendosjen e një afati.

17 Duhet vendosur një afat.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Strong.

19 Do të bëj një orvatje të fundit drejtuar Prokurorisë.

20 Znj. Prokurore, më duket që ju përmendët që nxjerrja  
21 sipas rregullit 103 është në përgjithësi "e përfunduar apo do  
22 të përfundojë në përgjithësi përpara konferencës së ardhshme  
23 për ecurinë e çështjes".

24 A mendoni se e gjithë nxjerrja do të bëhet pa ndonjë  
25 material apo mendoni se procesi do të zgjasë më shumë sesa

1 data e konferencës së ardhshme, domethënë, sesa gjashtë apo  
2 tetë javët e ardhshme?

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, e kam  
4 trajtuar këtë çështje në parashtrimet fillestare që janë  
5 depozituar dhe do të doja ta përsërisja dhe njëherë, që  
6 besojmë dhe mendoj që do të kemi përfunduar organizimin  
7 sistematik dokument për dokument të të gjithë dokumentacionit  
8 apo të koleksionit të dokumenteve që ne kemi në dispozicion.  
9 Ne po i nxjerrim dokumentet, ndërkohë që ato identifikohen dhe  
10 mendoj që do të ketë ca nxjerrje dokumentesh edhe pas kësaj  
11 date, në varësi të asaj se çfarë do të na nxjerrë shqyrtimi i  
12 dokumenteve dhe kontrolli, kërkimi që unë i përmenda dhe më  
13 përpara. Kështu që për momentin nuk është se mund të jap një  
14 datë specifike, një datë konkrete. Kështu që kemi qindra emra  
15 të cilët do duhet t'i kërkojmë në mënyrë që të bëhet redaktimi  
16 i dokumenteve përkatëse.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe, shumë  
18 shkurtimisht.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, shumë shkurtimisht do të flas.  
20 Do t'ju drejtoj një pyetje që t'ia drejtoni Prokurorisë juve,  
21 i nderuar Gjykatës.

22 A mund të na thoni se a ka ndonjë arsye që janë dashur 16  
23 muaj për këtë intervistë, domethënë, është një intervistë e  
24 cila është bërë në mars më 17 mars 2000, më falni, 2021 -  
25 korrigjim i avokatit. A mund të na thoni se si shpjegohet që

1 ky dokumentacioni i lidhur me të nuk është dhënë deri në vitin  
2 2022, më 1 shkurt 2022. Pra, këtë e theksoj dhe z. Strong dhe  
3 a ka ndonjë arsye se pse Prokurori që ka qenë i pranishëm në  
4 intervistën sipas rregullit 103 që të na thotë që pse kemi një  
5 vonesë prej 16 muajsh?

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A kemi ndonjë arsye  
7 konkrete se pse nuk është nxjerrë më përpara ky dokument?

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kjo lidhet drejtpërdrejt me  
9 kërkesat që unë bëra më përpara. Në qoftë se ekipet e  
10 Mbrojtjes dëshirojnë që të diskutojnë ndonjë kërkesë specifike  
11 atëherë duhet të na e bëjnë më përpara këtë synim të tyrin  
12 paraprakisht. Sepse nuk mund të jap historikun e të gjithë  
13 dokumenteve. Nuk mund të them se kur janë shkruar, kur janë  
14 zbardhur apo kur kemi bërë kërkesat.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju bëj thirrje palëve që të  
16 vazhdojnë me diskutimet ndërmjet palëve dhe që t'i referojnë  
17 çështjet e tjera në konferencën e ardhshme të ecurisë së  
18 çështjes në qoftë se është e nevojshme.

19 Kemi thujse një orë e gjysëm që nga koha që kur kemi  
20 filluar. Kështu që do të doja që t'ju kërkoja përkthyesve të  
21 më thonin në qoftë se mund të vazhdojmë për disa momente të  
22 tjera për të përfunduar me materialet që duhen nxjerrë në bazë  
23 të rregullit 107 përpara sesa të bëjmë pushimin?

24 Shoh që përkthyesit më thonë në rregull.

25 Atëherë le të kalojmë tek materialet nën rregullin 107.

1 Vërej parashtrimet e ZPS-së që ato po vazhdojnë që të punojnë  
2 në mënyrë aktive për të përfunduar diskutime sipas rregullit  
3 107. ZPS-ja thotë që ka -- është bërë progres. ZPS-ja thotë po  
4 ashtu që po përgatit disa kërkesa të tjera të cilat kanë të  
5 bëjnë me rregullin 107(2) duke reflektuar dhe marrëveshjet kur  
6 ato janë arritur. Dhe në parashtrimet e shkruara Mbrojtja  
7 vëzhgon se nxjerrjet e dokumenteve sipas rregullit 107 janë të  
8 paplota.

9 Ftoj ZPS-në që të flasë sa i takon afatit që ka të bëjë  
10 me kërkesat për materialet nën rregullin 107(2).

11 Znj. Prokurore, fjala për juve.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ne po vazhdojmë që të punojmë me  
13 materiale sipas rregullit 107. Një pjesë e tyre janë  
14 përfunduar në parashtrimin e protokolluar 678.

15 Aktualisht po punojmë për kërkesat sipas rregullit  
16 107(2), të cilat i përmendët dhe ju i nderuar Gjykatës. Duhet  
17 gjithashtu që të zgjidhim çështjen e diskutimit me një shtet  
18 individual, me një shtet të caktuar deri sa të përfundojmë me  
19 diskutimet. Ndërkohë që kemi një tjetër kërkesë, pra, një  
20 kërkesë të dytë, e cila po përgatitet, ka qenë nën përgatitje  
21 që disa javë më përpara, ka vijuar dhe në këtë javë. Dhe duhet  
22 shumë punë, në fakt, që të bëhen kërkesa të tilla dhe që t'i  
23 japim Gjykatës informacionet e nevojshme në mënyrë që të mund  
24 të ndihmojnë në vendimmarrjen e saj. Domethënë jemi në proces  
25 e sipër të përpilimit të kërkesave.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

2 Prokurore.

3 Mbrojtja, dëshiron që të marrë fjalën.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Po në qoftë se mund t'i jap fjalën

5 z. Misetit për Mbrojtjen, për ekipin tonë.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Përshëndetje. Mirëdita. Sa i takon  
7 rregullit 107, dëshirojmë t'ju bëjmë me dije, që ne duam që të  
8 theksojmë që provat që kanë si burim të tyre, në mënyrë të  
9 drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë, dokumente të cilat  
10 vijnë nga Republika e Serbisë ose nga organet e veta, neve i  
11 konsiderojmë këto materiale që bien nën rregullin 103 sepse,  
12 mendojmë, që kjo cek besueshmërinë dhe kredibilitetin e  
13 materialeve të ZPS-së. Kështu që mendojmë ta bëjmë, domethënë,  
14 është shumë e rëndësishme për neve për ta bërë këtë dallim dhe  
15 mendojmë që ky është material që bie nën rregullin 103. Pra,  
16 në qoftë se doni që të bëjmë një diskutim sepse mendojmë që ky  
17 informacion është i rëndësishëm që të shikohet nën këtë optikë  
18 dhe që lidhet kryesisht me Republikën e Serbisë, mund t'ju  
19 japim parashtrimet tona lidhur me të.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Znj. O'Reilly.

22 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar

23 Gjykatës. Ne i miratojmë parashtrimet e kolegut. Ne i shikojmë  
24 këto si dokumente të cilat mbështeten në rregullin 103.

25 Sa i takon rregullit 107. Ne kemi bërë kërkesë për të na

1 caktuar sasinë e dokumenteve të cilat duhet që të nxirren mbi  
2 bazën e rregullit 107 dhe, me ç'kuptoje, domethënë, ZPS-ja nuk  
3 ka dhënë asnjë përcaktim të dokumenteve të cilat bien në këtë  
4 rregull. Pra, unë dua që ZPS-ja tani t'i përgjigjet kësaj  
5 pyetjeje, sepse për ne është shumë e rëndësishme të dimë se sa  
6 sasi informacioni ose dokumentesh kemi, sepse duhet të bëjmë  
7 planifikimet sa i takon hetimeve dhe procedurave të tjera të  
8 cilat janë të rëndësishme për ne për t'u përgatitur për  
9 gjykimin.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Young, ndonjë gjë për të thënë.

12 Z. YOUNG: [Përkthim] Asgjë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, jemi dakord me ekipet e tjera të  
15 Mbrojtjes.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

17 Prokuroria, dëshiron që t'i përgjigjet elementit që  
18 ngriti Mbrojtja?

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Serbia nuk është një prej  
20 subjekteve ose vendeve të cilat bien nën dokumentet që janë  
21 për t'u nxjerrë mbështetur në rregullën 107.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Misetic.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, thjesht për ta sqaruar që ne  
25 duam që të dëgjojmë dhe ato materiale duhet që të informohemi

1 dhe për materiale që bien nën rregullin 103. Kjo thjesht për  
2 procesverbal dhe për t'u sqaruar.

3 Faleminderit.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Është ora 16.08. Ndërkohë do bëjmë pushim deri në orën  
6 16.35 edhe do vazhdojmë me seancën e dytë.

7 --- Pauza fillon në orën 16.08

8 --- Seanca rifillon në orën 16.37

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa  
10 të kalojmë në pikën tjetër në programin e ditës së sotme, do  
11 të doja t'iu kërkoja palëve që të na përditësojnë lidhur me  
12 diskutimet *inter parte* se për sa i takon *Legal Workflow* dhe  
13 transmetimit elektronik të dokumenteve ndërmjet Mbrojtjes dhe  
14 të akuzuarve që quhet me akronimin SSMEED.

15 Pra, janë ngritur dy çështje sa i takon Mbrojtjes.

16 Ndërkohë së pari dokumente të cilat janë nxjerrë në  
17 paketa të mëparshme, tani janë rinxjerrë me tituj të ndryshëm  
18 duke krijuar ngatërrim për ekipet e Mbrojtjes.

19 Së dyti, kemi dokumentet që janë kërkuar mbështetur në  
20 njoftimin sipas rregullit 102(3) që janë nxjerrë nën rregulla  
21 të tjera.

22 Dhe pastaj kemi edhe mospërputhjet në përshkrimet e  
23 dokumenteve, që njëherë për shembull i referohen emrit të një  
24 personi, ndërkohë që një herë tjetër i referohen pseudonimeve.  
25 Si dhe pra është e rëndësishme që të bëhen shpjegimet në

1 mënyrë të që të kemi gjithashtu edhe shpjegime të cilat janë  
2 efektive.

3 Gjithashtu domethënë dua të them që Mbrojtja e z.  
4 Krasniqi ka pasur vonesa në nxjerrjet elektronike dhe e njëjta  
5 gjë vlen edhe për ekipet e tjera.

6 Kështu që së pari, do të dua t'i jap fjalën Zyrës së  
7 Administrimit lidhur me sistemin gjyqësor që është *Legal*  
8 *Workflow* dhe SSMEDES.

9 Përpara sesa t'ju jap fjalën, vërej se galeria e publikut  
10 është e mbyllur. Nuk e di në qoftë se ka ndonjë arsye  
11 specifike konkrete për këtë. Nuk ka. Tani shoh që galeria e  
12 publikut u hap.

13 Tani më lejoni t'ia jap fjalën z. Nilsson lidhur me *Legal*  
14 *Workflow* dhe SSMEDE-në.

15 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 Lidhur me sistemin e punës së Gjykatës që quhet *Legal*  
17 *Workflow* dhe në veçanti mbushjen e rubrikave për dëshmitarët,  
18 pikë për të cilën juve pyetët mund të konfirmojë që Zyra  
19 Administrative ka përfshirë masat mbrojtëse përfshirë edhe  
20 linqet të cilat kanë të bëjnë me vendimet. Kjo është bërë për  
21 të gjithë dëshmitarët dje. Domethënë kjo pjesë e procesit të  
22 punës është përfunduar. Dhe ne kemi bërë çmos që të ndihmojmë.  
23 Pra ky është komenti që ka të bëjë me *Legal Workflow*.

24 Sa i takon çështjes së sistemit elektronik ose me  
25 shkurtesën SSMEDE, ne kemi marrë nga Mbrojtja e Krasniqit



1 komunikimin që ka të bëjë me këtë problem specifik, me  
2 problemin që ngritët dhe ju. E kemi shqyrtuar atë. Sistemi ka  
3 rreth një vit që funksionon dhe nuk është se kemi parë ankesa  
4 të kësaj natyre më përpara. Ndërkohë që kemi parë  
5 informacionet e hedhura, rubrikat përkatëse, pra kemi parë që  
6 dokumentacioni është futur në dosjen përkatëse më datë 6 mars,  
7 ashtu siç thotë dhe Mbrojtja dhe ka qenë e aksesueshme  
8 menjëherë në ditën pas kësaj. Pra mund të shikoheshin  
9 dokumentet.

10 Kështu që nuk mundëm të verifikojmë diçka tjetër. Pra  
11 periudha nga momenti i ngarkimit të materialeve deri kur mund  
12 të bëheshin të qasshme ato për Mbrojtjen ka qenë disa orë, jo  
13 në kohëzgjatjen që është thënë nga Mbrojtja.

14 Domethënë ky është pozicioni ynë. Gjithsesi jemi të  
15 lumtur që t'ju ndihmojmë - secilin prej ekipeve të Mbrojtjes  
16 me problemet që mund të kenë dhe mund t'i trajtojmë gjërat  
17 ndërmjet nesh edhe në qoftë se biem dakord nuk është e thënë  
18 që t'jua sjellim çështje të tilla në vëmendje.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Mbrojtja ka ndonjë gjë për të shtuar lidhur me këtë  
21 element?

22 Z. Kehoe.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund t'i jap  
24 fjalën z. Ellis për këtë pikë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara sesa të marrë

1 fjalën z. Ellis, dua të di në qoftë se ka ndonjë ekip tjetër  
2 Mbrojtjeje që do të marrë fjalën lidhur me këtë.

3 Z. Ellis, fjala për ju.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Lidhur me temën konkrete, më lejoni  
5 të them që ndoshta është para kohe për ta futur këtë në  
6 programin e konferencës për ecurinë e çështjes dhe jemi dakord  
7 me ato çfarë tha z. Nilsson. Domethënë jemi të kënaqur deri  
8 tani. Nuk kemi ndërhyrje, nuk kemi nevojë për ndërhyrjen tuaj.  
9 Jemi të kënaqur me ndihmën që kemi marrë nga Zyra  
10 Administrative dhe do të vazhdojmë që të ndërveprojmë me ta pa  
11 nevojën për t'i ngritur këto çështje përpara jush, shpresojmë.

12 Sa i takon sistemit Legal Workflow. Është një vend goxha  
13 dinamik për shkëmbimin e ideve. Megjithatë, mendoj se është me  
14 dobi që të kemi mundësi, që të flasim në mënyrë të  
15 drejtpërdrejtë me Prokurorinë, me Zyrën Administrative, me  
16 Avokatët e Viktimave për gjëra për shqetësime, të cilat  
17 ngriten.

18 Nuk ka asgjë në raport sa i takon rezolutës, megjithatë,  
19 ka disa tema të tjera të diskutimit, të cilat janë në vijim e  
20 sipër. Megjithatë, do të doja të thoja që do të vazhdojmë që  
21 të jemi të përfshirë në çështje të kësaj natyre.

22 Dhe në fakt kështu duhet të jetë, sepse në fund të ditës  
23 është një dialog. Kështu që në këtë pikë mund të them që është  
24 një dialog që vijon.

25 Sa i takon elementit të nxjerrjes të dokumenteve të

1 dëshmitarëve, ka ndonjëherë nxjerrje të dëshmitarëve të cilët  
2 nuk kanë lidhje fare me dokumentet. Kështu që do të donim që  
3 Prokuroria të jepte komentet e veta lidhur me këtë pikë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis. Sa i  
5 takon parashtrimin tuaj, e kam përfshirë atë në programin e  
6 konferencës për ecurinë e çështjes.

7 Znj. Prokurore, doni të komentoni apo të shtoni ndonjë  
8 gjë tjetër lidhur me sistemin *Legal Workflow*?

9 ZNJ. LAWSON: Siç u përmend edhe nga Zyra Administrative,  
10 masat përkatëse mbrojtëse për dëshmitarët janë futur në  
11 sistem. Jemi mirënjohës për ndihmën me procesin, ndërkohë që  
12 ZPS-ja tani po hedh emrat e dëshmitarëve.

13 Ndërkohë që sa i takon çështjeve të ngritura në  
14 parashtrimet e protokolluara të z. Veseli, unë dua të  
15 konfirmoj që kemi filluar që t'i shqyrtojmë shqetësimet e tyre  
16 dhe do t'i drejtohem ekipit të Mbrojtjes me shpjegimet  
17 përkatëse.

18 Lidhur me pikën e ngritur nga Mbrojtja e Krasniqit, unë e  
19 ftoj Mbrojtjen që të vijojmë me diskutimet *inter partes* për të  
20 ditur se për cilët dëshmitarë bëhet fjalë. Ka dokumente të  
21 cilët janë nxjerrë gjatë janarit, të cilat janë në proces të  
22 lidhjes tani, pra kësaj jave. Mbase këto janë dokumente, të  
23 cilat bihen brenda kësaj kategorie dhe siç e thashë jemi të  
24 gatshëm që të diskutojmë me Mbrojtjen përkatëse lidhur me  
25 këtë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. Laws, keni ndonjë koment për të bërë sa i takon  
3 sistemit Legal Workflow?

4 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo, nuk kam gjë  
5 për të thënë i nderuar Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le të kalojmë në  
7 çështjen e përkthimit të parashtrimeve të protokolluara dhe të  
8 materialit provues.

9 Ndërkohë, Mbrojtja e Krasniqit ka thënë se kemi 1144  
10 dosje [sipas përkthimit] të cilat janë në anglisht, ndërkohë  
11 që ka ende 214 dokumente, të cilat nuk janë përkthyer në  
12 shqip. Ndërkohë dua të di në qoftë se ndonjëra nga palët ka  
13 bërë ndonjë kërkesë urgjente për përkthim dhe në qoftë se Zyra  
14 Administrative mund të japë një vlerësim të kohës sa ose të  
15 përparësisë që mund të jepet për përkthimin e dokumenteve që  
16 janë pjesë e tabelës së rregullit 109(c).

17 Dua t'i ftoj palët që së pari të thoni që në qoftë se ka  
18 vështirësi sa i takon përkthimeve dhe së dyti në qoftë se  
19 është bërë prioritarizimi i parashtrimeve.

20 Pra z. Nilsson fjala për ju.

21 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit.

22 Ne jemi takuar më herët sot me Mbrojtjen e z. Krasniqi  
23 për të diskutuar tabelën në rregullin 109(c). Duke pasur  
24 parasysh kompleksitetin dhe madhësinë e materialit, opsioni që  
25 ne bëmë dhe që besoj që u pranua nga Mbrojtja është që ne do

1 t'ju vëmë në dispozicion përkthime të parashikuara dhe do t'ju  
2 japim paketat që janë afërsisht 50 faqe secila. Pra do të kemi  
3 mundësi që t'jua japim përkthimet me t'u përfunduar përkthimet  
4 gjatë muajit që vjen dhe shpresojmë që kjo të jetë mënyra më e  
5 shpejtë për të proceduar më tej. Për momentin duke parë  
6 situatën tani, paketa e fundit do të jepet në shtator,  
7 domethënë do fillojmë sa më shpejt të jetë e mundur dhe paketa  
8 e fundit do t'i jepet ekipit në shtator.

9 Domethënë ky është raportimi që kemi të bëjmë me këtë  
10 përkthim konkret.

11 Përveç kësaj kërkesë nuk kemi kërkesa të tjera që janë  
12 pezull që kërkojnë përkthim në mënyrë përparësore.

13 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit, z. Nilsson.

14 Mbrojtja dëshiron që të shtojë diçka lidhur me çështjen e  
15 përkthimit?

16 Z. Ellis.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Jemi dakord me parashtrimin që u bë  
18 lidhur me takimin që kemi bërë sot paradite. Jemi të kënaqur  
19 që të marrim përkthimet e parashikuara edhe më duhet të them  
20 që ishte një takim goxha produktiv.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

22 Z. Laws, keni ndonjë koment lidhur me çështjen e  
23 përkthimeve?

24 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo, i nderuar  
25 Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Laws.

2 Znj. Prokurore, keni ndonjë gjë për të shtuar?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar  
4 lidhur me këtë pikë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Tani dua që t'i kërkoj ZPS-së që të raportojë lidhur me  
7 gjendjen e hetimeve të saj.

8 Në parashtrimet paraprahe, ZPS-ja tha që hetimet lidhur  
9 me këtë çështje, janë kryesisht të përfunduara. Ndërkohë u tha  
10 që nuk kërkohet ndonjë shtyrje sa i takon çështjes e cila  
11 përfundon, do të fillojë për gjykim.

12 Megjithatë, Prokuroria tha që mund të nxirren ose mund të  
13 dalin në pah pista të reja dhe mund të duhet të përcaktohet e  
14 vërteta lidhur me ta.

15 U tha gjithashtu që dëshmitarët mbase nuk janë të  
16 disponueshëm ose mund të mos vijojnë me angazhimin e tyre. Dua  
17 që t'i kujtoj ZPS-së që hetimet e përgjithshme nuk është që të  
18 vazhdojnë gjatë gjithë gjykimit por flasim vetëm për prova apo  
19 për hetime të cilat kanë të bëjnë me gjëra të cilat janë  
20 përjashtimore.

21 Pra vetëm në rrethana - pra flasim këtu vetëm për  
22 rregullin, i cili është pjesë e rregullit njoftimit të  
23 rregullit 102(4). Pra, ZPS-ja thotë që pjesa dërrmuese e  
24 hetimeve ka përfunduar, kështu që në këtë pikë afati nuk është  
25 i nevojshëm.

1 Megjithatë, Mbrojtja parashtron se unë duhet të përcaktoj  
2 datën 6 maj 2022 si datën e përfundimit të hetimeve nga ZPS-  
3 ja.

4 Kështu që dua që t'iu kërkoj palëve që të më thonë në  
5 qoftë se mendojnë që afati zyrtar është i nevojshëm dhe në  
6 qoftë se po, çfarë duhet të bëhet - të cilët duhet të jenë  
7 përjashtime për hetimet përtej kësaj date.

8 Prokuroria.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

10 I keni përmbledhur në mënyrë të saktë parashtrimet tona.  
11 Pra, ne nuk e kemi përdorur fjalën që janë "në pjesën  
12 dërrmuese përfunduese" të përfunduara hetimet. Po në fakt  
13 është fraza që është përdorur prej jush, i nderuar Gjykatës,  
14 në konferencën e mëparshme për ecurinë e çështjes.

15 Pra në qoftë se keni pyetje të tjera lidhur me hetimin,  
16 ju lutem na thoni. Ne i kemi parasysh të gjitha parashtrimet  
17 tuaja dhe urdhrat e marra lidhur me hetimet nga Prokuroria.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Prokuror.

19 Z. Kehoe.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Do flas shkurtimisht, pastaj do t'i  
21 jap kolegut tim fjalën për komente shtesë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shumë shkurtimisht atëherë  
23 ju lutem.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Shumë shkurt do flas vërtet.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë jam goxha fleksibël,

1 por mundohuni që t'i ndani temat ndërmjet jush, sepse në qoftë  
2 se flitet më shumë sesa një person nga një ekip, atëherë i  
3 takon që do të marrim goxha më tepër kohë.

4 Z. Kehoe, kolegu juaj zakonisht është i shkurtër dhe  
5 konciz.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Dua t'ju tërheq vëmendjen lidhur me  
7 atë çfarë keni thënë më 4 shkurt, në konferencën e fundit për  
8 ecurinë e çështjes. Dhe kjo jepet në faqen 28 [sipas  
9 përkthimit]. Ju keni thënë që: "Mbrojtja nuk mund të pritët që  
10 të mbrojtë, që të përgatisë Mbrojtjen për një çështje e cila  
11 gjatë gjithë kohës është në evoluim e sipër, është në zhvillim  
12 e sipër."

13 Kur kam lexuar komentet e para të ZPS-së, domethënë që  
14 janë kryesisht "të përfunduara". Nuk e di çfarë do me thënë ky  
15 togfjalëshi. Në qoftë se janë të përfunduara, atëherë i takon  
16 që nuk kemi sepse e shtjellojmë më këtë çështje, por ajo çfarë  
17 duhet të sqarojmë është që duhet që çështja të mbyllet sepse  
18 në të kundërtën çështja do të zhvillohet e do të ketë evolime  
19 dhe zhvillime të reja nga Prokuroria për vite të tëra me radhë  
20 dhe klientët do të vazhdojnë që të jenë për vite të tëra të  
21 ndaluar. Pra, prandaj është e rëndësishme që atyre t'iu jepet  
22 një afat edhe mbas këtij afati, domethënë afati të respektohet  
23 edhe t'i qëndrojë Prokuroria afati.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Misetiç.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se do të kemi një debat



1 lidhur me atë se çfarë do të thotë që pjesa dërrmuese ka  
2 përfunduar, mendimi që kemi ne është që rregulli 108(b) dhe  
3 (c) të kërkon që të japësh materialin provues panelit të  
4 Trupit Gjykses. Dhe çështja është që Prokuroria duhet të  
5 përcaktojë se kur e ka gati çështjen për t'ia dorëzuar.  
6 Domethënë kjo është mënyra sesi e mendojmë ne pjesën që  
7 çështja ose hetimi është i përfunduar. Duhet të shikoni  
8 parashikimet përkatëse në rregullat e rregullores.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. O'Reilly.

10 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Dua ta  
11 trajtoj unë këtë çështje. Ju jeni shprehur në konferencën e  
12 mëparshme lidhur me këtë çështje.

13 Ndërkohë që pozicioni jonë është i thjeshtë. Askush nuk  
14 sugjeron që data 6 maj është një datë që duhet që të  
15 përfundojmë të gjitha hetimet, domethënë mund të ketë  
16 përjashtime. Ndërkohë që ne duam që të themi që është - bëhet  
17 fjalë për prova, të cilat janë pa precedentë.

18 Janë male të mbushura me prova. Janë prova të sasive të  
19 tilla, të cilat nuk janë parë në asnjë çështje tjetër të  
20 gjykatave ndërkombëtare. Dhe siç e keni pranuar me të drejtë,  
21 pra, duhet të përcaktojmë një afat të themi që kjo është pika  
22 fundore. Dhe për neve në fakt të bëjmë këtë diskutim në mars  
23 të vitit 2022 rreth faktit se kur Prokuroria duhet që të japë  
24 dosjen e vet ose kur të përfundojë hetimet e veta, në vetvete  
25 kjo është shumë problematike. Mendoj që problemi kryesor është

1 që vendimi i z. Black --

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Smith, jo z. Black.

3 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Prapë e  
4 thashë këtë. Pra vendimi i z. Smith që kishte parashtruar, iu  
5 kishte parashtruar disa dokumente ju, i nderuar Gjykatës dhe  
6 priste që ose që u vendos që të merreshe z. Thaçi dhe z.  
7 Veseli ndërkohë që hetimet sapo kishin filluar ose ishin në  
8 fazat fare të hershme të saj. Dhe me thënë të drejtën çdo  
9 Prokuror i ndershëm dhe çdo Prokuror profesional që unë kam  
10 hasur në arenën ndërkombëtare do ta kishte bërë këtë punë  
11 përpara sesa të ndalonte të akuzuarit. Pra ne në fakt çështjen  
12 e Prokurorisë do të duhet ta kishim marrë të plotë. Do të  
13 duhet të ishte dorëzuar e plotë disa javë pas arrestimit të të  
14 akuzuarve.

15 Sa i takon testit, mendoj që kjo është çështja kryesore.  
16 Ne parashtrojmë se testi kryesor është ajo që në arenën  
17 ndërkombëtare njihet si testi i provave të reja, domethënë  
18 ideja është që duhet të jenë prova tek të cilët Prokuroria nuk  
19 ka pasur qasje dhe në mënyrë të arsyeshme nuk mund të kishte  
20 pasur qasje përpara datës 6 maj. Dhe në këtë kuptim domethënë  
21 është provë e re, në kuptimin që ky është dokument i cili ka  
22 ardhur në zotërim të Prokurorisë në mënyrë të paparashikuar.

23 Por pavarësisht kësaj, deri më datë 6 maj, Prokuroria  
24 duhej që të nxirrte çdo gjë që kishte.

25 Pyetja që shtrohet tani është që pse ZPS-ja refuzon

1 përcaktimin e një date fikse për këto të dhëna të reja, prova  
2 të reja? Pra, përgjigjja që kam me këtë është që ose ata nuk  
3 mund të bëjnë dorëzimin deri më datën 6 maj - në qoftë se nuk  
4 e kam gabim është data 6 maj apo jo - sepse në qoftë se do ta  
5 përmbushnin këtë afat kohor siç nënkuptojnë atëherë i takon që  
6 nuk do të kishin kundërshtim fare që të përmbushej testi i  
7 provave të reja pas datës 6 maj.

8 Domethënë është një kufizim modest nga Prokuroria për  
9 këtë çështje që është përgatitur në mënyrë diskriminuese.

10 Domethënë ideja është që në qoftë se ata duhet që të  
11 japin provat e tyre deri më 6 maj, i takon që ata e dinë  
12 domethënë që provat që kanë deri tani janë të shumta, po  
13 ndërkohë nuk kanë ndonjë provë të madhe. Gjithsesi,  
14 pavarësisht kësaj do të duhet që ato të hetohen.

15 Ndërkohë që mendoj që çdo - pra në qoftë se neve flasim  
16 për afatin më datë 6 maj dhe në qoftë se ky afat i datës 6 maj  
17 nuk do të respektohet, atëherë është shumë e vështirë për neve  
18 që të kemi një çështje brenda vitit 2022. Domethënë në qoftë  
19 se Prokuroria do të vazhdojë dhe pas verës, do të vazhdojë që  
20 të mbledhë prova, atëherë do na vinte në një pozicion shumë të  
21 vështirë.

22 Në të kundërtën ne do të kishim pasur mundësi - nuk do të  
23 kemi mundësi që të parashtrojmë dosjen përfundimtare të  
24 çështjes gjyqësore.

25 Z. YOUNG [Përkthim]: S'ka nevojë për një afat. Nëse ka

1 pasur ndonjëherë ndonjë lëndë që ka pasur nevojë për një afat  
2 është pikërisht kjo dhe jam i sigurt që më kuptoni. Nëse  
3 Prokuroria tani po na thotë se janë të bindur se pjesa më e  
4 madhe e hetimeve kanë përfunduar, unë pyes në mënyrë retorike  
5 - përse i tremben ata një afati?

6 Unë e mbështet parashtrimin e z. Emmerson. Duhet të ketë  
7 një datë përfundimtare për arsyet e menaxhimit të mirë të  
8 çështjes, në këtë rast do të ishte 6 maji.

9 Dhe ju kërkojmë që të përcaktoni një afat të tillë, ta  
10 merrni vetë në dorë këtë gjë.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe i parashtrohemi, i bashkohemi  
12 parashtrimeve të tjera. Nuk shohim asnjë arsye pse mos të ketë  
13 një afat dhe pse duhet të vazhdojnë të zgjaten hetimet. Këtu  
14 duhet të heqim një vijë dhe të vendosim.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Prokuror, për çështjen e afatit të propozuar nga  
17 Mbrojtja, fakti që duhet të jetë 6 maj dhe propozimi për  
18 testin e provave të reja që ka propozuar z. Emmerson.

19 Dhe nëse ju kuptova drejt afati ka kaluar për ju sepse ju  
20 i keni finalizuar hetimet nëse nuk kërkon provë të reja për  
21 arsye të rrethanave të reja. Kështu nuk jeni shumë larg  
22 propozimit të z. Emmerson. Po mbase u keqkuptova në  
23 parashtrimet tuaja.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Së pari, po trajtoj afatin 6 maj.

25 Ju keni të drejtë kur thoni që s'është i nevojshëm afati

1 6 maj. Ai do të ishte për të siguruar që të përfundojë një  
2 gjë, por dhe testi i provave të reja apo i pranimit të daljes  
3 së çështjeve të tilla në çdo moment të gjykimit. Lidhur me  
4 këtë test ka dispozita ligjore këtu të zbatueshme dhe ne  
5 sugjerojmë nëse dhe kur kjo gjë do të ndodhë.

6 Ka hapa hetimorë të listuar në paragrafin 12 të  
7 parashtrimeve tona. Janë gjëra të nevojshme të lidhura me hapa  
8 hetimorë që duhet të bëhen. Janë gjëra të cilat mund të  
9 ndodhin me ecurinë e mëtejshme të gjyqit. Një është për  
10 shembull dëshmitarët e Mbrojtjes dhe ata që mund të dalin nga  
11 dëshmitë e tyre dhe askush nuk ka pse të thotë që ka ndodhur  
12 apo duhet të ndodhë por mund të ndodhë.

13 Kemi aspekte të hetimeve tona që kanë të bëjnë me gjëra  
14 si: intervistimi i dëshmitarëve që janë ndërkohë intervistuar  
15 apo kërkesa për materiale mjeko-ligjore lidhur me vrasje,  
16 gjëra të tilla. Dhe kur këto të jenë gati ne do të jemi në  
17 gjendje të bëjmë parashtrime. Por siç kemi thënë gjithnjë kjo  
18 nuk ka të bëjë me fushëveprimin e aktakuzës dhe teorinë e  
19 çështjes së ZPS-së në përgjithësi. Janë hollësi, të cilat  
20 bëjnë pjesë në fushëveprimin e hetimeve të ZPS-së.

21 Çështja që duhet të plotësojë ZPS-ja është aktakuza e  
22 konfirmuar siç parashikohet pra në rregullin 103 [sipas  
23 përkthimit]. Dhe për sa i takon nxjerrjes sipas përkthimit  
24 rregullit 103(2) [sipas përkthimit], nëse e dimë që nëse do të  
25 duhet të shtojmë materiale shtesë në këtë pikë, do të përdorej

1 shqyrtimi nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe në fillim, pastaj  
3 të tjerët.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Ato që tha kolegu i nderuar, çështja  
5 shtrohet se nëse ZPS-ja është angazhuar për diçka, për çfarë  
6 janë angazhuar ata? Për asgjë, as për një afat. Po i  
7 rezistojnë afatit të 6 majit dhe nuk iu përgjigjën as pyetjes  
8 suaj lidhur me testin e provave të reja. Dhe standardi është,  
9 a janë ata të gatshëm ta transferojnë çështjen përpara Trupit  
10 Gjykues? Në qoftë se nuk janë, atëherë i bie që të jenë ende  
11 duke hetuar. Dhe e vetmja gjë që duhet të trajtojnë është  
12 aktakuza që kemi përpara. Pse paska nevojë për hetime të reja?

13 Duket qartë që duan, përpiqen të nxjerrin akoma  
14 informacione të tjera, përveç atij malit me informacione që  
15 kanë. Dhe nuk duket se janë të gatshëm që ta transferojnë  
16 çështjen përpara Trupit Gjykues.

17 Tani për sa i takon angazhimit të tyre, ata nuk janë  
18 angazhuar për asgjë. Pra duhet të ketë një fund, duhet që  
19 këtij hetimi t'i vijë fundi.

20 Siç tha dhe z. Emmerson, ka fakte të reja që mund të  
21 kalojnë testin e provave të reja. Por kjo punë duhet të marrë  
22 fund. Ata kanë një çështje që zhvillohet, evoluon vazhdimisht.  
23 Në qoftë se nuk do të evoluojë vazhdimisht kjo çështje, nuk do  
24 të kishte nevojë për hetime shtesë. Edhe një herë parashtrojmë  
25 para jush, i nderuar Gjykatës që të përcaktoni një afat. Dhe

1 për ne 6 maji është dukshëm i arsyeshëm.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Dy gjëra.

3 Në qoftë se do të ishte një Prokurori që do të kishte  
4 përmbushur afatin dhe do t'u drejtohej juve duke ju thënë që  
5 ne kemi bërë pjesën më të madhe të punës por na duhet akoma,  
6 do të ishte diçka e pranueshme. Por kjo është një Prokurori që  
7 vazhdimisht ju ka keqinformuar që në fillim. Ju ka  
8 keqinformuar duke ju thënë që gjykimi duhet të fillonte që  
9 vitin që shkoi. Vazhdimisht i ka shkelur premtimet e veta  
10 lidhur me fillimin e çështjes. Ka një sasi monstruoze provash  
11 të paorganizuara si duhet, të pafokusuara dhe ne përfundojmë  
12 në situatën ku jemi tani. Dhe Prokurori ngrihet dhe thotë që  
13 duhet të na jepni udhëzime.

14 Kam frikë se Prokuroria në vetvete është arsyeja që duhet  
15 ta shqyrtoni me seriozitet dhe të vendosni ju vullnetin tuaj.  
16 Nuk është një vendosje, një imponim, është testi i provave të  
17 reja.

18 Testi provon se nëse është një material që është diçka që  
19 ka dalë nga provat e paraqitura nga Mbrojtja apo në mënyrë të  
20 papritur nga ndonjë dëshmitar apo gjithçka që mund të ishte në  
21 mënyrë realiste e përfutur dhe paraqitur para datës 6 maj,  
22 atëherë qartësisht një material i tillë do të kalonte testin.  
23 Por do të kërkonte një kërkesë të bërë përpara jush apo Trupit  
24 Gjykues sipas rastit. Kur Prokuroria do të dojë të kërkojë  
25 prova të reja, duhet pra padyshim që të kalojë testin, siç

1 janë pra, provat që dalin në gjyq. Në fund të fundit çfarë?  
2 Pse kundërshtojnë ata për vendosjen e një rregulli që thotë se  
3 pas 6 majit duhet të kërkon miratimin gjyqësor për atë test?

4 Në fakt Prokuroria duhet të fillojë ta trajtojë këtë  
5 çështje sidomos duke pasur parasysh historinë e zhvillimit të  
6 këtyre procedurave deri tani.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

8 Z. Prokuror, për sa i takon çështjes së transferimit të  
9 çështjes përpara Trupit Gjyqësor që është ngritur nga z. Kehoe  
10 dhe mesa shoh ka një miratim të përgjithshëm që ju të gjithë  
11 keni nevojë për leje gjyqësore për të nxjerrë dokumentet,  
12 materiale të tjera në bazë të rregullit 102(3) [sipas  
13 përkthimit] dhe afati fillon që sot në fakt - sepse duhet të  
14 shqyrtohet nga unë si Gjykatësi i Procedurës Paraprake apo nga  
15 Trupi Gjyqësor në të ardhmen për të vendosur nëse kjo provë  
16 duhet pranuar. Pra është një test që duhet përdorur në atë  
17 rast. E kam të drejtë?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Po, plotësisht të drejtë. Dhe ne  
19 kështu mendojmë.

20 Një gjë tjetër që duam të themi.

21 Z. Kehoe ju keqcitoi atë që keni thënë ju. Në faqen 928  
22 të transkriptit ju keni thënë, rregulli 104 [sipas përkthimit]  
23 e konfirmon këtë kundërshtim. Dhe sot thatë diçka të ngjashme.

24 "Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme mund të nxirret  
25 prova shtesë dhe më pas të përdoret në gjyq. Mbrojtja nuk



1 pritet të përdorë mbrojtjen për një çështje që evoluon  
2 vazhdimisht.”

3 Gjykata nuk ka thënë se çështja e ZPS-së po evoluon  
4 vazhdimisht.

5 Ju po flisnit për detyrimin e nxjerrjes dhe specifikisht  
6 për rregullin 104 [sipas përkthimit]. ZPS-ja i reziston - nuk  
7 e pranon nocionin se çështja e saj po evoluon vazhdimisht. Dhe  
8 në këtë nivel ne nuk kemi asnjë problem që edhe kështu në  
9 fazën që jemi çështja t’i transferohet Trupit Gjykues.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se është e vërtetë atëherë  
12 ta bëjmë, transferoheni çështjen. Të kalojmë te testi i  
13 provave të reja dhe të paraqitet çështja përpara Trupit  
14 Gjykues. Kjo është përgjigjja. Mos të vazhdojmë të flasim me  
15 fjalë, të shkëmbejmë fjalë. Sigurisht që çështja evoluon  
16 vazhdimisht. Çfarë bëjnë ata në qoftë se nuk e hetojnë? Po e  
17 zgjasin e po e zgjasin për të gjetur gjëra të tjera.

18 Mbylleni këtë punë dhe transferoheni çështjen përpara  
19 Trupit Gjykues dhe të mbarojë hetimi i tyre. Në qoftë se duan  
20 të ndryshojnë diçka është testi i provave të reja.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

22 Për pikën tjetër të programit, ia jap fjalën Mbrojtjes në  
23 fillim.

24 Lidhur me hetimet e Mbrojtjes, kam dëgjuar që disa ekipe  
25 tuaja kanë përmendur për sa kohë që nuk mbaron nxjerrja e

1 materialeve është shumë vështirë për ne, pra si Mbrojtje të  
2 propozojmë ndonjë afat kohor për hetimet në përgjithësi.

3 Megjithatë, jam i interesuar të dëgjoj mendimin e  
4 Mbrojtjes lidhur me statusin e hetimeve të tyre. Dhe çdo  
5 informacion që mund të ketë lidhur me afatet do të vlerësohej  
6 edhe pse e kuptoj plotësisht që është vështirë të angazhohesh  
7 për të thënë një afat të përcaktuar sot.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, ne do ta parashtrojmë çështjen  
9 tonë paragjyqësore sa më shpejt. Dhe ne duam ta çojmë çështjen  
10 sa më shpejt në gjyq, sa më shpejt që të jetë e mundur.

11 Ne jemi duke hetuar me gjithë kufizimin që kemi pasur dhe  
12 bëhet fjalë për një numër faktorësh.

13 Për redaktime shumë të mëdha edhe për deklaratat e  
14 dëshmitarëve. Dëshmitarë anonimë kemi 103 nga 206 [sipas  
15 përkthimit] që janë anonimë. Kemi vazhduar nxjerrjen e  
16 rregullit 103 [sipas përkthimit] dhe ajo që është shqetësuese  
17 për ne, janë ato nxjerrje që nuk na janë bërë të njohura, nuk  
18 na janë vënë në dispozicion. Është vështirë ne si Mbrojtje  
19 thashë që të japim një vlerësim, sepse kemi gjithë këto  
20 çështje të pazgjidhura. Me këto fjalë megjithatë ne mesa  
21 mundemi jemi duke e hetuar çështjen në bashkëpunim me klientët  
22 në mënyrë të vazhdueshme.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

24 Z. Emerson.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Z. Strong

1 do ta trajtojë pasi ai është këshilltari kryesor për hetimet.

2 Z. STRONG: [Përkthim] Faleminderit.

3 Kemi përfunduar shqyrtimin fillestar të dosjes paraprake  
4 të Prokurorisë. Mund të trajtoj disa çështje që kemi në një  
5 vend tjetër. Por kemi bërë pra udhëtimin e parë hetimor në  
6 Kosovë. Ka disa pengesa të cilat i kam parashtruar në  
7 parashtrimin tonë.

8 E para është që duhet të realizojmë objektin e çështjes  
9 së Prokurorisë. Kemi detyrimin profesional të përgatisim  
10 çështjen tonë si Mbrojtje. Si vuri në dukje z. Emmerson,  
11 vëllimi i informacionit është i paparë nga gjithë përvoja ime.  
12 Nuk dua që të përdor vetëm përvojën time. Kemi bërë një  
13 vrojtim të 53 lëndëve ndërkombëtare për të marrë një farë  
14 informacioni dhe për t'u orientuar dhe është e qartë që nuk  
15 është një listë shteruese. Por sa për të thënë që kjo çështje,  
16 pra vëllimi i kësaj çështjeje është jashtëzakonisht - e  
17 tejkalon çdo lloj matje, qoftë nga numri i provave materiale,  
18 numri i dëshmitarëve që propozohen. Është dhjetë herë më e  
19 madhe se çështja e Sainoviçit. Dhjetë herë më shumë prova  
20 materiale nga Xhorgjeviçi, Sainoviçi dhe Stanisiçi. Këto janë  
21 raste të rëndësishme, çështje të rëndësishme të TPNJ-së. Pra  
22 të Gjykatës për ish-Jugosllavinë. Pra i zgjodhëm si pika  
23 krahasimi më këtë çështje.

24 Gjithsesi, në bazë të çdo lloj matjeje, kjo çështje është  
25 shumë e madhe pra për qëllimet e hetimit. Në qoftë se do të

1 shkurtohej do të ishte mirë të bëhej sa më shpejt dhe jo më  
2 vonë sepse Gjykata ka burime të kufizuara për t'u përdorur për  
3 çështje që të cilat në fund të fundit do të hidhen poshtë, do  
4 të hiqen.

5 Në qoftë se ZPS-ja është e vendosur në qëllimin e saj që  
6 të mos e shkurtojë apo zvogëlojë çështjen e saj apo provat e  
7 saj, duam të dimë sesi ata duan t'i zgjidhin disa probleme.  
8 Me 1863 orë që parashikojnë po t'i pjesëtojmë me katër orë në  
9 ditë të kushtuara vetëm për provat kryesore, i bie që të ketë  
10 gjashtëqind e ca ditë [sipas përkthimit] për vazhdimin e  
11 gjyqit.

12 Pra sa ditë mund të mbliidhet Gjykata, mund të punojë  
13 Gjykata duke pasur parasysh shumë faktorë për të mos  
14 përllogaritur kundërpjetet apo pyetjet e palës kundërshtare.  
15 Pra duam të dëgjojmë se si ZPS-ja synon ta zgjidhë këtë  
16 çështje, sepse kemi një klient në paraburgim që i ndjek me  
17 vëmendje dhe shikon mundësinë e një gjyqi që mund të vazhdojë  
18 dhjetë vite. Askush në këtë sallë gjyqi nuk do që kjo të  
19 ndodhi. Pra sa më shpejt që ta trajtojmë këtë aq më mirë do të  
20 ishte.

21 Pengesa e dytë që ne hasim dhe e kemi trajtuar më parë  
22 është materiali i rregullit të nxjerrjes së vonuar. Dhe nga  
23 gjashtë javët e fundit kemi parë se Mbrojtja ka shpenzuar  
24 kohë, burime, ndonjëherë gjashtë muaj për të zgjidhur një  
25 çështje që vetëm një dëshmitar që ka dhënë intervistë në

1 2019-n e zgjidhi për minuta. Pra duke pasur parasysh madhësinë  
2 e kësaj çështjeje nuk është një rrugë që mund të përdoret,  
3 praktike për të vazhduar për të kryer hetimet. Kjo është një  
4 arsye tjetër për se ne duhet që ta marrim informacionin sa më  
5 shpejt ta kemi në dorë.

6 Dhe e fundit ka të bëjë me kohën, me afatin. E dëgjuam  
7 Prokurorinë. Disa herë ka thënë që çështja e Mbrojtjes nuk do  
8 të thotë që duhet të jetë e plotësuar, e përfunduar që të  
9 fillojë gjyqi. Por nëse dhe do ta mendonim një gjë të tillë,  
10 ne duhet të dimë rendin e dëshmitarëve të parë që Prokuroria  
11 do të thërrasë me qëllim që dhe ne ta organizojmë kohën dhe  
12 energjitë tona përkatësisht.

13 Kërkuam vetëm 30 dëshmitarët e parë që do të përbënin 10  
14 për qind të numrit të tyre. Pra 107 dëshmitarë që do të ishin  
15 30 për qind. Duam të dimë rendin konkret të 30 dëshmitarëve të  
16 parë, mbi të cilët të përqendrohemi dhe numrin e përgjithshëm  
17 të 30 për qindëshit.

18 Kaq kërkojmë lidhur me fillimin e kësaj çështjeje.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Strong.

20 Z. Young.

21 Z. YOUNG: [Përkthim] Shumë shkurt. E vërteta është që  
22 hetimet e Mbrojtjes janë në vazhdim e sipër. Por siç thanë  
23 kolegët, ne po pengohemi shumë nga çështjet që mendojmë se i  
24 kuptoni. Siç tha dhe kolegu, objekti i redaktimeve i  
25 aktakuzës, redaktime në dosjen paraprake, në materialet bazë,

1 numri jashtëzakonisht i madh i dëshmitarëve, vonesat në  
2 nxjerrjen e materialeve nga ZPS-ja, veçanërisht të materialeve  
3 102(3).

4 Ju dëgjuat më parë në këtë seancë se ne kemi identifikuar  
5 dhjetëra mijëra dokumente që i kemi gjykuar se janë me rëndësi  
6 materiale për përgatitjen e Mbrojtjes. Nuk i kemi dhe nuk e  
7 dimë se kur do t'i kemi. Në qoftë se do të fillojmë diskutime  
8 për rëndësinë e tyre materiale dhe ato janë me shumë rëndësi  
9 pra siç thashë për ne. Është vështirë të flasësh për hetimet  
10 tona në këto kushte.

11 Ka një mori arsyesh pse kërkohet shumë më tepër kohë nga  
12 ana jonë.

13 Faleminderit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

15 Z. Ellis.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Po. Ne si të gjithë kolegët, ne po  
17 ecim në hetimet tona. Po ecim sa më shpejt që të jetë e mundur  
18 me gjithë kufizimet që kemi. Edhe ne kemi zhvilluar një mision  
19 kohët e fundit hetimor në Kosovë. Kemi folur me dëshmitarë të  
20 mundshëm aty dhe gjatë. Kemi planifikuar hetime të mëtejshme  
21 në një të ardhme të afërt.

22 Por asnjë nga këto nga nuk cenon qëndrimin tim që shpreha  
23 në fillim. Çfarë duhet të bëhet në fillim është nxjerrja e  
24 plotë e dokumenteve nga Prokuroria. Dhe atëherë do të jemi në  
25 gjendje t'ju japim një mendim më të saktë lidhur me afatet.

1 Ju bashkëngjitemi dhe ne parashtrimeve të kolegëve,  
2 sidomos të z. Strong, që kërkojnë nxjerrjen e hershme të  
3 identiteteve të dëshmitarëve të parë të Prokurorisë sepse mua  
4 më duket një hap krejtësisht i arsyeshëm, do të na ndihmonte  
5 që t'i orientonim edhe hetimet tona.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

7 Të kalojmë tani te tema e fundit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të dëgjohemi dhe ne?

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më falni.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Nja dy përgjigje të shkurtra dhe  
11 një pak më të gjatë lidhur me objektin e çështjes sonë sepse u  
12 vu në dukje nga kolegët e Mbrojtjes.

13 Është e qartë që të gjithë palët janë të gatshëm të  
14 punojnë për ta çuar çështjen në gjyq. Është e drejta e  
15 Mbrojtjes të hetojë sa më shumë që të dojë. Por kjo nuk mund  
16 të kushtëzohet nga hetime, të cilat Mbrojtja mund t'i bënte  
17 dhe ka zgjedhur të mos i bëjë. Ka disa gjëra që nuk janë  
18 konsekuente në ato që ka thënë Mbrojtja. Dhe ju drejtoj në  
19 faqet 971-972, sidomos lidhur me parashtrimet e Mbrojtjes së  
20 Thaçit. Janë disa gjëra që u thanë tani që nuk marrin parasysh  
21 vendimet tuaja të mëparshme.

22 Redaktimet në aktakuzë në dosjen paraprake, ato janë të  
23 gjitha të autorizuara në mënyrë ligjore. Mbrojtja thotë që ka  
24 nevojë për këto lloj informacionesh për të hetuar. Duket sikur  
25 vë një kusht. Dhe disa kushte nuk mund të përmbushen deri 30

1 ditë përpara gjyqit. E kështu ju e keni thënë vetëm në  
2 vendimet tuaja.

3 Lidhur me renditjen e dëshmitarëve, rendi i dëshmitarëve  
4 të Prokurorisë varet shumë nga fillimi i gjyqit, nga plani i  
5 seancave dhe ne kërkojmë që kjo çështje t'i përçohet Trupit  
6 Gjykues për të vendosur se kur do ta bëjë.

7 Çështja kryesore që dua të adresoj këtu ka të bëjë me  
8 fushëveprimin apo objektin e çështjes. Aktakuza është  
9 konfirmuar për këtë çështje. ZPS-ja ka të drejtë të ketë të  
10 gjithë mundësinë për ta paraqitur çështjen e saj. Kjo mundësi  
11 lidhet me provat e propozuara, orët e marrjes në pyetje dhe  
12 provat e nxjerra. Modeli i sjelljes kriminale ka shumë rëndësi  
13 lidhur me vendndodhjet e krimit, duke ditur për shembull që  
14 Prokuroria në TPNJ nuk arriti të provonte modelin e përhapur  
15 të sulmeve kundër në çështjen Limaj. Dhe i referohem  
16 paragrafit 228 të Limajt dhe 228 të aktgjykimit të Haradinaj  
17 të vitit, të 3 prillit 2008.

18 Statistikat, shifrat që ju paraqiti Mbrojtja e Veselit  
19 tani dhe në parashtrimet me shkrim për natyrën e paprecedentë  
20 të çështjes së Prokurorisë nuk mundësojnë një krahasim të  
21 njëmendte. Në fakt janë keqorientues dhe mund të jap dy arsye  
22 sepse është e tillë.

23 Siç u vu në dukje nga vetë Mbrojtja e Veselit në  
24 parashtrimin e saj me shkrim numri që ato kanë paraqitur ka të  
25 bëjë me provat e pranuar dhe jo me ato në listën origjinale.



1 Lista aktuale pasqyron ato që mund të pranohen në gjyq, por  
2 mund të parashikohet që numri konkret mund të jetë shumë më  
3 pak, si shembull çështja e Karaxhiçit nga 600 [sipas  
4 përkthimit] e ca prova që u paraqitën. Në ndryshim, lista e  
5 provave të Prokurorisë në TPNJ kaloi 23 mijë prova të tilla me  
6 ecurinë e çështjes.

7 Pika e dytë që duhet përmendur është që ZPS-ja përcakton  
8 provat e saj në një formë tjetër krahasuar me TPNJ-në apo të  
9 tjerë, në një formë më të gjatë. Bëhet fjalë për shembull një  
10 intervistë me një dëshmitar W664 [sipas përkthimit] ka pesë  
11 PDF dhe ka dhe pesë përkthime shqip dhe pesë përkthime në  
12 serbisht që i bashkëngjiten.

13 Në fakt nga 16 deri në 30 lista kanë të bëjnë vetëm me  
14 intervistën e një dëshmitari.

15 Mënyra sesi numërohet një provë ka një numër, ka një  
16 efekt shumë të madh në numrin e provave që pretendon Mbrojtja.  
17 Por fakti që thonë që është i paprecedentë, nuk qëndron.

18 ZPS-ja ka parasysh që orët e marrjes në pyetje mund të  
19 jenë të pakufizuara, por ne thjesht përpiqemi që të  
20 thjeshtojmë procesin.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim]

22 Z. Kehoe.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Shkurtimisht. Mendoj që kolegu nuk  
24 po kupton diçka.

25 Nuk po e kupton këtë që po themi. Mbrojtja është penguar

1 shumë për të mësuar një pjesë të madhe të informacionit për  
2 shkak të asaj që ka bërë Prokuroria. Ka vënë një listë me 500  
3 [sipas përkthimit] e ca dëshmitarë që kërkojnë vite. Pra ka  
4 ndonjë çështje që të jetë, t'i ngjasojë sadopak çështjes së  
5 Prokurorisë? Jo. Qëndrimi i ZPS-së është që një çështje e  
6 zakonshme, është absurde. Ata duan ta shkurtojnë këtë çështje.  
7 Në qoftë se duan ta shkurtojnë na e jepni, të na japë një  
8 listë realiste të dëshmitarëve se ne kemi folur me disa nga  
9 këta dëshmitarë që janë në listë. Ata nuk e dinë fare që janë  
10 dëshmitarë, për të mos folur që s'u është marrë miratimi. Nuk  
11 e dinë që janë dëshmitarë.

12 Hiqini ata dëshmitarë. Prokuroria nuk do t'i thërrasë.  
13 Pse i ka futur në listë që të na ngatërrojë neve.

14 Ne nuk po themi që duhet -- thuhet me saktësi çdo gjë në  
15 hetimet e Mbrojtjes kur të fillojë çështja. Ne nuk e kemi  
16 parashtruar kurrë një qëndrim të tillë. Por ne po punojmë me  
17 shumë vendosmëri dhe zell, me informacion jashtëzakonisht të  
18 redaktuar, me një të tretën e dëshmitarëve që nuk e dimë akoma  
19 se kush janë dhe këtë kemi thënë gjithnjë. Në qoftë se duam që  
20 çështja të ecë përpara sa më shpejt, hiqini redaktimet. Na e  
21 jepni një kopje të redaktimeve.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Të gjitha redaktimet janë  
23 autorizuar në mënyrë ligjore. Janë me vendimin tim.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, por po flasim për pengesat që  
25 kemi hasur.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Misetiç.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkurtimisht dua të ngre çështjen  
3 që kemi qenë jokonsekuente në qëndrimin tonë që u tha. Flasim  
4 për argumentin në kontekstin e protokollit dhe është  
5 keqparaqitur argumenti ynë. Argumenti ynë është që ne e  
6 filluam hetimin. Nuk thamë që e filluam hetimin në tetor-  
7 nëntor. Por që Prokuroria na e dha listën e dëshmitarëve në  
8 nëntor-dhjetor të 2020 dhe u ndje rehat që ne vazhduam hetimet  
9 tona aq sa mundeshim derisa ata bënë kërkesën në dhjetorin e  
10 2021-shit. Nuk thamë që i filluam atëherë hetimet.

11 Dua të them gjithashtu që është çështje provash. Ata kanë  
12 kontakt me dëshmitarët. Në qoftë se ata hasin të dhëna, dëshmi  
13 të cilat lidhen dhe me dëshmitarët tanë mund të na i paraqesin  
14 ne.

15 Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Tani të kalojmë tek tema e fundit që ka të bëjë me  
18 efikasitetin e shpejtësinë e procedurave. Dhe këtë pikë e  
19 filluam sepse z. Strong e paraqiti me gojë atë që kishte  
20 parashtruar në parashtrimin me shkrim për të thjeshtuar  
21 çështjen.

22 Në urdhrin për caktimin e datës së kësaj konference për  
23 ecurinë e çështjes u kërkoval palëve që të japin mendimin e  
24 tyre nëse do të ishin në gjendje që të zhvillonin diskutime  
25 *inter partes* dhe/ose të parashtronin propozime me shkrim për

1 mbarëvajtjen e procedurës gjyqësore që do të përfshihej në  
2 dokumentin për kalimin e çështjes së parashikuar në rregullin  
3 98(e) të Rregullores dhe kjo nëse do të bëhej deri në  
4 konferencën e 12-të për ecurinë e çështjes. Unë kam dhënë disa  
5 shembuj, për shembull janë afatet për paraqitjen e provave të  
6 palëve dhe/ose bërjen e pyetjeve të dëshmitarëve, kufizimin  
7 mbi numrin e dëshmitarëve dhe përdorimi i provave me shkrim  
8 dhe i mocioneve të paraqitjes jo-gojarisht të provave.

9 Në parashtrimet e tyre, Mbrojtja e Veselit tashmë ka bërë  
10 disa sugjerime. Unë gjithashtu dëshiroj që t'i pyes palët në  
11 qoftë se bihen dakord për diskutimet *inter partes* në këtë temë  
12 dhe/ose nëse mund të japin parashtrime mbi këtë temë përpara  
13 konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ne me kënaqësi mund ta bëjmë këtë  
15 në bazë *inter partes*. Unë jam në gjendje që tani që të them  
16 diçka sa i takon propozimit që kemi paraqitur sepse ka dy  
17 rrugë kryesore për thjeshtimin. Mund të bëhet - ka të bëjë me  
18 uljen, pra me pakësimin e numrit të pikave për të cilat palët  
19 nuk pajtohen dhe gjithashtu edhe me numrin e orëve të  
20 vlerësuara.

21 Sa i takon numrit të pikave të cilat palët nuk pajtohen,  
22 nuk ka pasur ndonjë progres kushedi se çfarë.

23 Deri tani kryesisht ka qenë në formën e kërkesave  
24 sipërfaqësore, për shembull çfarë date është kjo, kush ishin  
25 këta persona dhe nuk kemi marrë propozime të qenësishme.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ndërkohë që Mbrojtja nuk ka  
2 marrë të gjitha nxjerrjet, është e vështirë që Mbrojtja të  
3 pajtohet për pikat faktike. Kështu që unë mendoj se është  
4 shumë e vështirë që Mbrojtja t'i përfundojë këto diskutime.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Patjetër, absolutisht. Por,  
6 Mbrojtja jo medoemos duhet që të pajtohet për asgjë në këtë  
7 çështje. Edhe kur jepet ky informacion, Mbrojtja s'e ka të  
8 detyruar për shembull që të bjerë dakord për themelimin e UÇK-  
9 së përpara periudhës që është përfshirë në aktakuzë apo për  
10 detaje të tjera apo siç është data e krijimit.

11 Por ashtu siç e ka mbajtur qëndrimin Mbrojtja hë për hë  
12 është që kjo kufizon thjeshtimin në funksion të mbarëvajtjes.  
13 Kjo ka të bëjë me listën e konsoliduar të pikave faktike dhe  
14 juridike, për të cilat palët mund të pajtohen dhe nëse ka  
15 kundërshtim Mbrojtja për këtë apo jo.

16 E fundit sa i takon - e fundit ka të bëjë me mocionin për  
17 pranimin jo-gojarisht, për paraqitjen jo-gojarisht të provave.

18 Sa i takon një vlerësimi, ZPS-ja ka marrë një nismë për  
19 ta zvogëluar numrin e orëve të vlerësuar për këtë çështje  
20 gjyqësore, në veçanti sa i takon kohës së nevojshme për t'u  
21 bërë pyetje disa dëshmitarëve. Dhe gjithashtu ka të bëjë edhe  
22 me gatishmërinë tonë për të paraqitur më shumë prova sipas  
23 rregullave 153 dhe 155. Lidhur me këtë duhet që të mbajmë  
24 parasysh edhe ato rregulla të rregullores, të cilat e  
25 kufizojnë përdorimin e deklaratave për t'u paraqitur si prova

1 në proces. Ka nga ana tjetër disa viktima për të cilat - e  
2 kanë shumë të rëndësishme që historinë e tyre tua thonë  
3 drejtpërdrejt anëtarëve të Trupit Gjykses. Edhe këto duhen  
4 mbajtur parasysh.

5 Po ZPS-ja angazhohet që ta pakësojë numrin e vlerësuar të  
6 orëve për paraqitjen e provave nga ana e saj. ZPS-ja po  
7 përpigjet që të bëjë ato pakësime të numrit të orëve të  
8 parashikuara që do të mundet. Ne do të jemi në gjendje që t'i  
9 drejtohem Gjykatësit të Procedurës Paraprake, sa i takon  
10 numrit të orëve, të cilat do të shkurtohen.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. Kehoe. Ju lutem nuk kemi diskutime për anën materiale.  
13 Më shumë për procedurën, për procesin që do të ndiqet.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe ne kemi disa sugjerime  
15 rudimentare. Siç e dini, i nderuar Gjykatës, përpara tre  
16 ditësh ne morëm një listë sërish të ndryshuar të provave  
17 materiale. Kemi tani mbi 16.000, pra 16.280 materiale [sipas  
18 përkthimit]. Ndërsa sa i takon faqeve, 1209 [sipas përkthimit]  
19 që është ndryshuar para tre ditësh. Kemi 326 dëshmitarë dhe  
20 kemi dhe këtu dokumentin tim dhe të preferuar sepse kemi të  
21 bëjmë me 18.063 orë.

22 Sigurisht Prokuroria mund ta kufizojë këtë, sepse nuk  
23 mund t'i thërrasë, nuk mund të bëj sens që t'i thërrasë të 326  
24 dëshmitarët. Jo të gjithë këta dëshmitarë që janë në listë të  
25 përfshirë nga Prokuroria, janë në dijeni që Prokuroria ka

1 ndërmend që t'i thërrasë. Kjo domethënë është pikërisht një  
2 pamje e parë. Tani po t'i hymë në thelb një prove që ata do të  
3 përpiqen që të paraqesin para Trupit Gjykses, sigurisht topi  
4 është në gjysmë-fushën e tyre. Dhe ata mund të bëjnë disa  
5 gjëra, disa gjëra shumë konkrete për ta shkurtuar kohën.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

7 Z. Emerson.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë do të  
9 përqendrohem te aspektet procedurale nëse mundet.

10 Me shumë kënaqësi do të diskutonim me Prokurorinë sa i  
11 takon procesit të pakësimeve, të shkurtimeve. Por nuk dua që  
12 të harxhoj shumë kohë me diskutime *inter partes* që me gjasë do  
13 të jenë të padobishme. Prandaj unë mendoj që më e logjikshme  
14 do të ishte, që sigurisht do të pyes se cili është qëndrimi i  
15 atyre, por ne do të bëjmë parashtrimet me shkrim para  
16 konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes.

17 Qëndrimi ynë - dua të jem i qartë - është se e vetmja  
18 mënyrë për të arritur një farë disipline në paraqitjen e  
19 provave në gjykim nga ana e Prokurorisë është të bëhet ajo që  
20 kanë bërë të gjithë gjykatat e tjera ndërkombëtare. Është që  
21 të thuhet kaq kohë keni, kaq kohë ka në dispozicion Prokuroria  
22 për të paraqitur provat e veta dhe pastaj le të vendosë vetë  
23 Prokuroria se në cilët dëshmitarë do që të fokusohet. Një prej  
24 disiplinimit më të mirë që mund të bëjë për sa i takon kohës  
25 në gjykim është që ta detyrosh palën që të fokusohen, të

1 mbledhin mendjen dhe kjo do ta pengonte Prokurorinë që të mos  
2 fuste lloj-lloj gjërash. Dhe kjo do ta fokusonte Prokurorinë.  
3 Prandaj është mirë që dëgjojmë nga Prokuroria që janë të  
4 gatshëm që të shkurtojnë në një farë mase numrin e orëve. Por  
5 ne mendojmë se në themel është e rëndësishme që Prokurorisë  
6 t'i caktohet një kohë e caktuar dhe pastaj Prokuroria i vendos  
7 vetë prioritetet e veta.

8 Gjëja më e thjeshtë që mund t'i bëjmë pyetje vetes është  
9 kjo - çfarë mund të konsiderojë Gjykatësi i Procedurës  
10 Paraprake apo Trupi Gjykues si një afat apo periudhë të  
11 arsyeshme për zhvillimin e këtij gjykimi. Sepse gjithmonë  
12 duhet që të dyfishohet për shembull koha që nevojitet nga  
13 Prokuroria sepse kemi katër ekipe mbrojtjeje. Të paktën them  
14 që dyfishohet.

15 Kushdo qoftë zyrtari kryesor që do e marrë vetë këtë  
16 vendim, ju vetë apo Trupi Gjykues është që domethënë edhe dy  
17 vjet të tjera nëse do të vazhdojë kjo? Apo edhe 18 muaj gjysma  
18 e kësaj t'i caktohet Mbrojtjes dhe gjysma tjetër të jetë  
19 kufizim maksimumi që mund t'i jepet Prokurorisë për të  
20 paraqitur provat.

21 Nuk ka nevojë që t'ju bind, të nderuar Gjykatës. Janë  
22 gjëra të cilat i dimë të gjithë për shumë kohë. Sepse nëse  
23 vendosim presion, vendosim këtë kufizim kohor për Prokurorinë,  
24 do të shikojmë se në fund fare e gjithë çështja do të jetë  
25 pastaj më e pastër, më e qartë, më e fokusuar. Sepse nëse flas



1 për shembull nga vetja ime, nëse ke një kufizim kohor për një  
2 dëshmitar, nuk rri e zgjat, e çon edhe flet dhe për gjëra të  
3 mërzitshme për të gjithë. Besoj se të gjithë e dimë se në këtë  
4 çështje, Prokuroria ka qenë joprofesionale dhe materiali që  
5 është përfshirë aty, ka lloj-lloj materialesh, të cilat jo  
6 medoemos të gjitha janë të rëndësishme apo kanë lidhje të  
7 drejtpërdrejtë me çështjet.

8 Por megjithatë, besoj se ata do të binden nëse kanë një  
9 kufizim kohor. Po në fund të fundit edhe ata do të jenë  
10 mirënjohës, pra nga ana e Prokurorisë sepse kështu do të  
11 fokusohen më mirë dhe do vendosin prioritetet. Sepse  
12 materialet që na janë paraqitur deri tani, në tërësinë e tyre  
13 janë pështjelluese, jo të qarta.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emerson.

15 Z. Young, keni fjalën.

16 Z. YOUNG: [Përkthim] Edhe ne jemi të gatshëm të  
17 diskutojmë me Prokurorinë si gjithmonë.

18 Sa i takon të tjerave që u thanë këtu, mbështes atë që  
19 tha z. Kehoe dhe z. Emerson se nuk besoj që ia vlen t'i  
20 përsëris të gjitha.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

22 Z. Ellis.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne mbajmë të njëjtin qëndrim.  
24 Besoj se ne gjithmonë kemi treguar gatishmëri për diskutime  
25 *inter partes*. Kjo s'përbën përjashtim.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

2 Z. Laws.

3 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ne kemi interes  
4 për këtë çështje. Për procesverbalin, edhe ne me shumë  
5 kënaqësi do të donim të merrnim pjesë në diskutimet *inter*  
6 *partes* sa i takon thjeshtimit për mbarëvajtjen e kësaj  
7 çështjeje.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë, z.

9 Laws.

10 Unë i falënderoj të gjithë palët dhe pjesëmarrësit për të  
11 filluar diskutimet. Bie dakord me z. Emmerson që nuk - që kjo  
12 nuk duhet të zgjasë për shembull gjashtë muaj. Këtë diskutime  
13 *inter partes* duhet të jenë të kufizuar në kohë. Kështu që i  
14 ftoj të gjitha palët që të i përmbyllin diskutimet e tyre  
15 përpara konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes.

16 Dhe meqenëse ra fjala te konferenca e ardhshme për  
17 ecurinë e çështjes --

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, z. Emmerson.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] A mund të  
20 specifikoni që diskutimet *inter partes* duhet të përfundojnë  
21 mjaftueshëm paraprakisht para konferencës së ardhshme të  
22 ecurisë së çështjes me qëllim që të kemi mundësi që të bëjmë  
23 parashtrime me shkrim lidhur dhe me këtë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju kuptova. Do të lëshoj  
25 urdhër gojarisht për këtë në fund të kësaj konference.

1 Tani sa i takon datës së konferencës së ardhshme për  
2 ecurinë e çështjes, unë mendoja që ta bënim më datë 16 maj,  
3 por fatkeqësisht kjo datë s'është më e mundshme. Kështu që  
4 mendoj që ta parashikoj konferencën e ardhshme për ecurinë e  
5 çështjes për të premtën, 20 maj 2022, në orën 14.30 me orën e  
6 Hagës. I kërkoj palëve të konfirmojnë disponueshmërinë.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, jemi të gatshëm të marrim  
8 pjesë kur ta gjykojë Gjykatësi.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Kehoe.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, faleminderit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, pa  
14 problem.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Young.

17 Z. YOUNG: [Përkthim] Po, do të jemi këtu.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

19 Z. ELLIS: Do të jemi këtu.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Laws.

22 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, jemi të  
23 gatshëm.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Laws.

25 Do të merrni urdhrin për caktimin e datës që do të

1 përfshihet ne rendin e ditës përpara konferencës së ecurisë së  
2 çështjes në momentin e duhur.

3 Tani pyes palët nëse kanë ndonjë parashtrim që duan të  
4 bëjnë.

5 Z. HALLING: [Përkthim] E vetmja gjë është që duam që të  
6 ngremë ka të bëjë me parashtrimin e protokolluar të z. Thaçi  
7 me numër F00741 që ka të bëjë me protokollin e kontakteve.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk e di nëse doni që të  
9 flisni dy minuta apo më shumë.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Do të thosha pesë minuta.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Është 5.41. Ne po i  
12 afrohem dhe fundit.

13 Z. Misetiç.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të them që duhet të jeni të  
15 sigurt që dhe ne do të kemi diçka për të thënë lidhur me këtë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ma lexuat mendjen. Preferoj  
17 që t'i bëni parashtrimet me shkrim, z. Prokuror.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Me kënaqësi.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

20 Z. Kehoe.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon dëshmitarëve anonimë,  
22 kemi një sërë dëshmitarësh me masa mbrojtëse.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Të cilët nuk do të jenë  
24 anonimë. Nuk do të jenë anonimë deri në fund të procedurës.

25 Dhe të cilët, të gjithë janë autorizuar nga unë z. Kehoe.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Po për sa i takon këtyre  
2 dëshmitarëve, unë e kuptoj se shumë njerëz në media në Kosovë  
3 kanë dalë publikisht pra me këto. Kështu që duhet që Dhomat e  
4 Specializuara të rishikojnë se kush janë këta dëshmitarë, për  
5 të cilët s'janë më të nevojshme masat mbrojtëse në mënyrë që  
6 të hiqen masat mbrojtëse për ata dhe të ecim me këta  
7 dëshmitarë si me çdo dëshmitar tjetër në dallim nga masat  
8 normale të mbrojtjes.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.  
10 Znj. Prokurore, dëshironi t'iu përgjigjeni z. Kehoe.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo shumë. Sigurisht ne e mbajmë  
12 nën vëzhgim të - e mbajmë në vëzhgim situatën e sigurisë edhe  
13 rrethanat e veçanta të çdo dëshmitari. Kaq.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. Emerson, keni gjë për të thënë?

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Young.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] Jo, faleminderit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

21 Z. Ellis.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, asgjë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws.

24 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Asgjë më tej, i  
25 nderuar Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit, z. Laws.

2 Përpara se ta mbyllim këtë seancë sot, do të lëshoj tre  
3 urdhra gojarisht.

4 Urdhri i parë gojarisht ka të bëjë me riklasifikimin e  
5 parashtrimit të protokolluar F744.

6 Më 22 mars, me një parashtrim me shkrim, ZPS-ja kërkonte  
7 riklasifikimin e parashtrimit të protokolluar me numër F744 si  
8 konfidencial. ZPS-ja parashtron se informacioni që i ishte  
9 nxjerrë Mbrojtjes në mënyrë konfidenciale duhet të vijojë të  
10 qëndrojë konfidencial pavarësisht nga disponibiliteti i  
11 mundshëm publik i ndonjë prej këtyre informacioneve.

12 Mbrojtja e Veselit përgjigjet se parashtrimi i  
13 protokolluar F744 nuk është nevoja të riklasifikohet si  
14 konfidencial duke qenë se i intervistuari nga ZPS-ja nuk është  
15 dëshmitar i mbrojtur dhe se marrëdhënia e ZPS-së me  
16 autoritetet përkatëse është në domeinin publik. ZPS-ja  
17 kundërpërgjigjet se Mbrojtja e Veselit nuk ka justifikim që të  
18 anashkalojë kornizën e zbatueshme ligjore dhe me nismën e  
19 vetëm të riklasifikojë informacionet konfidenciale që përmban  
20 parashtrimi F744.

21 Duke mbajtur parasysh parashtrimet e palëve, konstatoj se  
22 megjithëse disa informacione të përgjithshme sa i takon  
23 çështjeve në fjalë, mund të gjenden në domeinin publik të  
24 dhënat e këtyre aspekteve dhe/ose konfirmimi i tyre mbeten  
25 konfidenciale.

1 Prandaj urdhëroj Zyrën Administrative të riklasifikojë  
2 parashtrimin F744 si konfidencial dhe të dorëzojë një version  
3 të redaktuar publik të këtij parashtrimi të protokolluar sa më  
4 shpejt.

5 Këtu mbyllet ky urdhër i parë gojarisht.

6 Do të lëshoj tani urdhrin e dytë të lëshuar gojarisht sa  
7 i takon propozimeve për mbarëvajtjen e çështjes.

8 I ftoj palët dhe pjesëmarrësit që të vijojnë me  
9 diskutimet *inter partes* se si të thjeshtohet mbarëvajtja e  
10 kësaj çështjeje.

11 Dhe urdhëroj që për propozime të tilla të palëve të  
12 parashtrihen brenda datës 20 maj 2022.

13 Propozime të tilla do të përfshijnë ndër të tjera numrin  
14 e dëshmitarëve që do të thirren, mënyrën e dhënies së dëshmisë  
15 që do të përdoret, përdorimin e provave me shkrim dhe  
16 përdorimin e mocioneve për paraqitjen e provave jo-gojarisht  
17 dhe afatet kohore me paraqitjen e provave nga palët.

18 Këtu mbyllet urdhri i dytë i lëshuar gojarisht.

19 Do të lëshoj tani një urdhër të tretë gojarisht për  
20 nxjerrjen e materialit 103.

21 Duke pasur parasysh që nxjerrja e materialit të rregullit  
22 103 është një proces i vazhdueshëm. Gjithsesi urdhëroj ZPS-në  
23 që brenda datës 20 maj 2022 të përfundojë shqyrtimin e 2500  
24 materialeve që mbeten për t'u caktuar për shqyrtim shfajësues.

25 Këtu mbyllet urdhri i tretë i lëshuar gojarisht.

1 Këtu mbyllet kjo seancë e sotshme. Si zakonisht,  
2 falënderoj palët dhe pjesëmarrësit për praninë. Falënderoj  
3 përkthyesit, stenografët, personelin audioviziv dhe personelin  
4 e sigurisë.

5 Këtu mbyllet seanca.

6 --- Seanca mbyllet në orën 17.47

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25